

Debat publik

Dilema rreth kompetencave të ATO-s

Fq.3



SHEKERINSKA NË PRISHTINË

Maqedonia mbështet Ushtrinë e Kosovës

Fq.4



Fyen Trumpin


SHBA i refuzon vizën

Fq.20



Koha

www.koha.mk



KOHA për anigma

Fq.11-14

AKTUALE

“Shuplakat” nisin nga e para



Ndryshimet në Këshillin Penal për rastin “Shuplakat”, ishin arsyeja kryesore se pse kjo lëndë të premtën filloi të procedohet nga e para në Gjykatën Penale të Shkupit. Kryetari i ri i Trupit gjykues, Dushan Josifovski, tha se Ligji për procedurë penale, doemos e parasheh nisjen e procesit nga e para, me këtë edhe leximin e propozim akuzës dhe prezantimit të dëshmive. Prokurorja speciale...

Fq.5

RAJON

Shqipëria e para në Evropë për rrezikun nga tërmetet

Fq.16

SPECIALE

Kthesë në Oksford, tani vajzat janë më shumë se djemtë!

Fq.15



AFARISTËT E BRENGOSUR, GJURMËVE TË ANKESAVE

EKONOMIA NËN HIJEN E POLITIKËS



Çështja e emrit, Ligji i gjuhëve, plani 3-6-9 sikur kanë lënë në harresë zhvillimin ekonomik të shtetit, thonë analistët ekonomik. Nga ekzekutivi i ri thonë se kriza politike është tejkaluar, por pasojat e ngërçit politik ndjehen akoma

Fq.7

Libri dhe familja më të rëndësishme se çerdhet

Shkup, 2 shkurt - Është bërë thaujse e zakonshme që nëpër studimet e ndryshme për cilësinë në arsimin fillor shkaqet për performancat e dobëta të kërkohen në mosfrekuentimin e institucioneve të parashkollore. Për të argumentuar këtë, shfrytëzohen çdoherë të dhëna që flasin për përfshirje jo shumë të lartë të fëmijëve nëpër kopshte dhe çerdhe. Megjithatë, studime të tjera flasin se argumenti i ndjekjes

ose jo të arsimit parashkollor nuk mjafton për të mbështetur tezën se ky është faktor i rëndësishëm për cilësinë e mësimin, sidomos të nxënësve të ciklit të ulët të arsimit fillor. Kopshtet dhe çerdhet, sipas një pjese të mirë të ekspertëve të fushës, nuk janë më të rëndësishme se familja dhe biblioteka. Madje, këta të fundit, sikurse shprehet Elizabeta Bajrami Ollogu, profesoreshë në...

Fq.6



EDITORIAL

PATRIOTIZMI
I STIROPORIT

Emin AZEMI

Problemet që ka Maqedonia me Greqinë, as për së afërmi nuk prezantohen në media, për arsye se dimensionin e këtyre problemeve sa është aktual e gjeostrategjik, po aq është edhe historik e identitar. Dy opinione krejt të ndryshme publike, të kundërvënë përballë njëri tjetrit, njëri në sheshet e Athinës e Selanikut, e tjetri në studiot televizive të Shkupit, sikur nxjerrin në pah dallimet në qasje dhe perceptim. Nga zhvillimet e raportuara në media, mund të vërejmë një aktivizim më të madh të vëmendjes publike në Greqi, për dallim nga maqedonasit (një pjesë bukur e madhe e tyre) të cilët ende vazhdojnë të besojnë se problem më i madh për ta është gjuha shqipe, se sa ndërrimi i emrit të shtetit.

Asgjë të re në këtë drejtim nuk do të thoshim, nëse e kemi parasysh faktin se disponimi publik tek maqedonasit një kohë të gjatë ka kaluar nëpër valvulat e trajnimit antishqiptar, ndërkohë që çështjet identitare ata i kanë konsideruar, dhe ende i konsiderojnë, si tema nacionale për përdorime të brendshme, që do të aktivizoheshin varësisht se cila koniunkturë politike është në pushtet. Këto tema, në vend se ti trajtojnë si probleme kryesore kombëtare, ata po i trajtojnë si kanale rezervë për të përçuar mesazhe nga njëri tabor politik te tjetri, duke e mbuluar krejt këtë me ambicjet për marrje ose ruajtje të pushtetit. Asgjë më tepër.

Ky qëndrim kaq latent i opinionit publik maqedonas kundrejt qëndrimeve rigjide greke, ka një shpjegim psikologjik që zberthen një koncept mental i cili nuk është mësuar të ballafaqohet me të vërtetat reale dhe për pasojë fillon të projektojë të vërteta paralele, në formë mirazhesh në shkretëtirë, që lëvizin nga periudha e maqedonasve antikë deri në periudhën e maqedonasve të Blazhe Konevskit. Pamundësia për të mbushur këtë hark kohor, mbi dy mijë vjeçar, me teatër, letërsi, arkitekturë, pikturë, e ka transformuar vetëdijen kolektive nga fotografia reale në lëvizje të robotizuar, që hapëron nga legjendat e mjegullta antike në patriotizmin e pluhurosor me grimca stiropori në arkitekturën e shpifur të barokut.

Burime të afërta me negociatorët për çështjen e emrit, vënë në dukje se pala greke është kategorike në kundërshtimin e gjithçkaje që lidhet me historinë e asaj që ata e quajnë Maqedoni. Kjo i bie që për Athinën zyrtare janë të papranueshme termat që përkufizojnë shtetin, popullin dhe gjuhën e Maqedonisë. Grekët do të pajtoheshin me gjithçka tjetër që është jashtë këtyre përkufizimeve, madje edhe me një gjuhë që e flasin shumica e popullsisë, por që nuk do të quhej "maqedonishte". Ta përkthesh në sens emocional këtë pretendim të fortë grek, nuk është edhe aq vështirë, sepse shqiptarët ka kohë që në kurrizin e tyre po e ndjejnë kategorizimin e famshëm statistikor të 20%, që me aq zell është patentuar në formulimet kushtetuese e ligjore të politikanëve të Shkupit. Pra, për ta kuptuar se sa dhemb kungji i Athinës, maqedonasit do të ishte mirë ta shohin se sa me sherr e kishin mprehur kungjin e tyre në kuzhinat politike të Shkupit, ku brenda natës gjuha shqipe nga kategoria socio-lingvistike transformohej në kategori statistikore. Në këtë mënyrë do të ndodhte një proces i çuditshëm politik-antropomorf, teksa shqiptarët futeshin në një magazinë të braktisur tekstilësh ku shpejt e shpejt në vend të emrave iu qepeshin numrat që tregonin se janë një grumbull frymorësh në këtë shtet qesharak që assesi spo mundet të gjejë një emër që i kënaq të gjitha palët.

Shqiptarët e kanë dëgjuar që moti përrallën për gropën që kishte gllabëruar të parin të zotit e saj që e kishte bërë, por nuk duan të besojnë që mendësia refuzuese ndaj tyre mund të ketë ndonjë pikëtakim paradokosal me thirrjet anarkiste në Greqi.



KUSH FITOI, GREQIA APO SHQIPËRIA

"Ministri grek thotë (i kënaqur) se Greqia fiton 12 milje det! Ministri shqiptar thotë (duke mos e përgënjeshtuar) se marrëveshja është shumëfish më e mirë se ajo e vitit 2009, të cilën e hodhi poshtë Gjykata Kushtetuese! Unë kam qenë i dobët në matematikë, është mirë dikush ta sqarojë në emër të shtetit shqiptar si ndodhë që pala greke të fitojë 12 milje, ndërkaq edhe Shqipëria të ketë fituar shumëfish! A do të thotë kjo se të dy palët kanë marrë ujëra detare nga fjiu i tretë, Italia!? Në Athinë: punë e kryer...! Në Tiranë belbëzime jo bindëse: ende s'kanë përfunduar bisedimet! Ministri Ditmir Bushati deri tash nuk e ka përgënjeshtuar Koxiasin!", shkruan në profilin e tij në Facebook publicisti nga Shkupi, Daut Dauti.

INFERIORITETI I DYFISHTË SHQIPTAR

"Apatia e shqiptarëve të Maqedonisë ndaj çështjes së emrit shpërfaq edhe njëherë internalizimin apo 'epidermalizimin' i inferioritetit të dyfishtë shqiptar. Është e dyfishtë ngaqë e ndjejnë kolonizimin e kolonizatorit të tyre. Me një fjalë, shtresa politike Maqedonase është gjuhëzuar para politikave të jashtme greke dhe nuk ka asnjë kompromis në çështjen e emrit, por ka një diktat dhe imponim të pa kompromis të palës greke. Greqia, nuk ka asnjë ekskluzivitet të pronësimit të emrit 'Maqedoni'. Arbitrariteti ndërkombëtar është zhgënjyes dhe frustrues. Se kush duhet të bëhet pjesë e NATO-s, e kush jo, vendosin donatorët e mëdhenj të saj, e jo Greqia. Nëse maqedonasit dhe roqëtarët e këtij shteti sillen si të kolonizuarit e grekëve, shqiptarët s'kanë nevojë të ndjehen si të tillë! Para se të dënohen politikisht fashiste të Greqisë, duhet të kritikohet fort presioni i një anshëm politik ndërkombëtar", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Latif Mustafa.

ZËRI I NATASHËS KUNDËR FASHIZMIT SERB

"Deputetëve të Kuvendit të Kosovës: të nderuar zonja dhe zotërinj, më 31 janar 2018 senatori amerikan Roger Eicker and përfaqësuesi Eliot Engel nominuan Natasha Kandiçin dhe fondin për të Drejtën Humanitare për Çmimin Nobel për Paqe 2018. Natasha Kandiç dhe FDH kanë qenë dhe mbeten dokumentuesit kryesorë të krimeve e viktimitave të luftërave të ish Jugosllavisë dhe kanë qenë dhe janë bartësit kryesorë të shtyllës kryesore të idesë se pajtimi mes kombeve e qytetarëve mund të bëhet nëpërmjet të ballafaqimit me të kaluarën. FDH, themeluar nga Natasha Kandiç, është sot i vetmi institucion i besueshëm që ka dokumentuar luftën në Kosovë dhe krimet e bëra në të. Kujtesa kolektive e Kosovës së luftës në masë të madhe është ruajtur falë punës së FDH dhe Natasha Kandiçit. Përgjatë viteve të zhbërjes së ish Jugosllavisë, zëri i Natasha Kandiçit ka qenë i qartë në vetminë dhe guximin e vet, kundër fashizmit serb dhe fashizmave të tjerë. Sugjeroj që Kuvendi i Kosovës, me pajtim të gjitha grupeve parlamentare, të votojë një Rezolutë për kandidimin e Natasha Kandiçit dhe FDH-së për Çmimin Nobel për Paqe 2018. Me këtë do të nderonte jo vetëm punën e vetmohueshme të FDH-së dhe Natasha Kandiçit, por edhe idenë, më se të nevojshme për Kosovën dhe tërë regjionin, e pajtimit të popujve dhe qytetarëve nëpërmjet të ballafaqimit me të kaluarën", shkruan në Facebook, Veton Surroi.

MEDIACitate

Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska, e cila po qëndron për vizitë zyrtare në Kosovë u prit në takim nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Në një njoftim nga Kryeministria e Kosovës thuhet se pjesë e diskutimit në këtë takim ishte thellimi i bashkëpunimit në shumë fusha me rëndësi për të dyja vendet, veçanërisht në fushën e sigurisë, ekonomisë dhe infrastrukturës, menaxhimi i përbashkët i kufijve dhe tema të tjera në interes reciprok. Në njoftim poashtu theksohet se kryeministri Haradinaj në këtë takim ka thënë se, "Ky është shansi që Kosova dhe Maqedonia të vendosin bashkëpunimin për fqinjësi të mirë, sidomos tani kur ka vullnet politik nga të dyja vendet". Ndërkaq, ministrja Shekerinska ka thënë se "duhet të fuqizohen raportet me fqinjët në baza të komunikimit të përditshëm për punët që i preokupojnë të dyja vendet". Me rastin e vizitës së ministres Shekerinska, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) organizoi një ceremoni ushtarake. (Anadolu Agency, 2 shkurt)

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ka kritikuar ashpër liderët e Kosovës për iniciativën e shfuqizimit të Gjykatës Speciale. "Me demarkacionin Kosova arriti ta krijojë një problem që nuk është problem duke e vënë në lojë gjithë partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket Gjykatës Speciale ishte gabimi më i madh që bënë në këtë partneritet", ka thënë Rama. Ai duke folur për veprimet e liderëve kosovarë kohë e fundit ka thënë se i duhet të jetë shumë i hapur me ta dhe tua thotë troç atë që mendon. Kosova është atdheu i të gjithë kosovarëve, por është fëmijë i atyre që e bombarduan Serbinë, ka thënë Rama. Ai ka thënë se qëndrimin e tij ua ka thënë në sy krerëve të shtetit kosovar, se Kosova është në një fazë të rrezikshme dhe duhet të përqendrohet tërësisht te bisedimet me Serbinë në mënyrë që ta zgjidh atë nyjë dhe të vazhdojë përpara me integrimet. (KTV, 2 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇKA ËSHTË DITA BOTËRORE E "TOKAVE TË LAGURA"?

Dy shkurti i çdo viti është shpallur si "Dita Botërore e Ligatinave"; kjo ditë shënon datën e miratimit të Konventës për Ligatinat në 2 Shkurt 1971 në qytetin Iranian të Ramsar-it. Ligatinat ose sistemet e "tokave të lagura", janë sipërfaqe ujore të përhershme ose përkohshme deri në 6 metra thellësi, dhe përbëjnë një ekosistem mjaft i rëndësishëm që siguron larmi përfitimshëm përfshirë filtrimin e

ujit, sigurimin e biodiversitetit, mbrojtjen e bregdetit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Publiku i gjerë është pak i ndërgjegjshëm për këto shërbime të rëndësishme të ligatinave. Dita Botërore e Ligatinave është një mundësi e mirë për të kërkuar ndryshimin e situatës dhe ndërgjegjësuar publikun mbi rëndësinë që kanë ligatinat për të ardhmen e njerëzimit.

DEBAT PUBLIK PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE

DILEMA RRETH KOMPETENCAVE TË ATO-S

Ekspertët shpalosën dilemat sa i përket kompetencave të Agjencisë Teknike Operative, ndërsa përfaqësues nga organizatat joqeveritare kërkojnë të dinë se ku do të qëndrojnë aparatat për ndjekje të komunikimeve, kush do të bëjë porosinë e saj dhe cilit do t'i takojë përgjegjësia në rast keqpërdorimi

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 2 shkurt - Gjatë debatit publik të premten në Parlament mbi propozim-ligjet, njëri për ndjekje të komunikimeve dhe tjetri për themelimin e Agjencisë Teknike-Operative nga ekspertët pati mendime të ndryshme sa i përket këtyre ligjeve, gjegjësisht ndaj kompetencave të Agjencisë. Ndërkaq përfaqësues nga organizatat joqeveritare kërkojnë të dinë se ku do të qëndrojnë aparatat për ndjekje të komunikimeve, kush do të bëjë porosinë e saj dhe cilit do t'i takojë përgjegjësia në rast keqpërdorimi. Në këtë pikë, ata u interesuan të dinë nëse në vend ka akoma pajisje mobile për përgjim dhe vallë Ministria e Punëve të Brendshme posedon informacion për raste eventuale.

"Neni 17 është problem serioz në aspektin e aparaturës së veçantë, sepse humb kuptimi i Agjencisë Teknike Operative. Humb kuptimi i ATO-së dhe hapet mundësia për keqpërdorim, sepse me këtë ligj për ndjekje të komunikimeve, organi që zbaton masat posedon edhe aparaturën", tha Jove Jovčevski, ekspert për

ndjekje të komunikimeve. Ai shtoi se Ligji për ndjekje të komunikimeve bie ndesh me Ligjin për procedurë penale, me çka tha Jovčevski, krijohet një mishmash kompetencash mes Agjencisë Operative-Teknike dhe institucioneve gjyqësore në këto dy ligje. Zgjedhja e kuadrove profesionist dhe përfaqësimi nacional ishin kërkesat e profesorit universitar, Bashkim Selmani. "Përkujdesja e dy elementeve. E para ka të bëjë me buxhetin, sa Ligji parasheh anën materiale dhe e dyta - të bëhen përzgjedhje të individëve dhe t'u jepet rasti gjeneratave të reja të cilat janë në numër të madh dhe janë mjaft të zgjuar", deklaroi Selmani. Ekspertët, po ashtu rekomanduan edhe saktësimin e situatave kur zbatohen masat e posaçme hetuese, si dhe pavarësinë nga pushteti i institucioneve që duhet të zbatojnë këto ligje. Vlerësimet ishin pozitive për modelin e Agjencisë Teknike-Operative, përveç përfaqësuesve të operatorëve telekomunikues, të cilët kërkojnë që harxhimet për sigurimin e aparaturës së ATO-së, t'i mbulojë Ministria e Punëve të Brendshme. Nga

ana tjetër, ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski siguroi se Agjencia Teknike Operative do të ketë mbikëqyrje të rreptë nga disa institucione shtetërore. "Sipas propozim-ligjit, të drejtë për mbikëqyrje të punës së ATO-së do të kenë Kuvendi, Drejtoria për sigurimin e informacioneve të klasifikuara, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, Avokati i Popullit dhe Këshilli për Kontroll Qytetar", deklaroi ministri Spasovski. Kishte dhe ekspertë që ishin kritik për vonesën e debatit publik. Në këtë rast, kryetarja e Komisionit parlamentar për mbrojtje dhe siguri, Frosina Remenski, shpjegoi se Rregullorja e Parlamentit mundëson që diskutimi të bëhet mes leximit të parë dhe leximit të dytë të propozim-ligjit. Ndryshe, opozita maqedonase bojkotoi diskutimin. Përveç deputetëve, në diskutim nuk morën pjesë as kryetari i Komisionit për mbikëqyrje të punës së DSK-së dhe Agjencisë së Inteligjencës, Trajko Veljanovski dhe kryetari i Komisionit për mbikëqyrje të zbatimit të masave të posaçme hetuese, Emil Dimitriev. Sa i përket kompetencave të Agjenci-

së Teknike Operative, sipas Ligjit, ajo nuk vendosë së kush do të përgjohet, por se vetëm zbaton vendimet e prokurorisë. Aktualisht, për ndjekje të komunikimeve qoftë dhe pa urdhër gjyqësor vendos ende Drejtoria për Siguri dhe kundërzbulim. Vitin e kaluar kishte iniciativë për të kërkuar mendim në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me këtë kompetencë të DSK-së, por që Qeveria me pas hoqi dorë që të merr vlerësim nga Gjykata Kushtetuese me arsyetimin se po përgatitet Ligji i ri për ndjekje të komunikimeve. Sa i përket zhvillimeve tjera në Parlament, deputeti i VMRO-së Antonio Milloshoski të premten dorëzoi kërkesë që në rend dite të vendoset edhe pika për zgjedhjen e përbërjes së re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Tetë nga nëntë anëtarët të KSHZ-së parashtruan dorëheqje në funksionet pas çka u konstatuan nga Parlamenti pasi në opinion ishte zbardhur se ato kanë përcaktuar kompensime të larta si paushall për disa cikle zgjedhore. Aktualisht KSHZ ka vetëm një anëtar - edhe atë zonja Emira Asani Salija e propozuar nga Lëvizja Besa.



Zaev shpreson në zgjidhje për emrin deri nga mesi i vitit

Shkup, 2 shkurt - Kryeministri Zoran Zaev pret që deri nga mesi i vitit të gjendet zgjidhje për kontestin 25-vjeçar për emrin me Greqinë dhe në Samitin e NATO-s në qershor të aktivizohet ftesa për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë. Në deklaratë për televizionin bullgar "Nova", Zaev thotë se zgjidhja eventuale do të duhet të miratohet në referendum. "Referendumi duhet të jetë garancë shtesë edhe për miqtë tanë nga Republika e Greqisë, pasi me këtë definitivisht do të hiqen të gjitha dyshimet, ndërsa populli do të qëndrojë pas zgjidhjes, e cila do të pranohet. Jam i bindur se maqedonasit janë të gatshëm për këtë. Por, ende jemi në negociata dhe shpresoj se zgjidhja do ta ruajë dinjitetin e qytetarëve edhe të Greqisë edhe të Republikës së Maqedonisë", tha Zaev. Ai shtoi se "së bashku me fqinjët jugorë nga Greqia bëjnë çmos që të hapet debat i brendshëm dhe të gjendet zgjidhje e pranueshme për të dy palët". "Shpresoj se do të gjejmë zgjidhje, të cilat janë mjaft të pranueshme për të dy palët për shkak se në fund zgjidhja duhet ta ruajë dinjitetin dhe identitetin e dy vendeve. Vetëm ashtu ndërtohen miqësi dhe kjo duhet të jetë në një bazë të përhershme dhe të qëndrueshme. Tërë këtë e them për shkak se nëse bëhemi të mençur më herët ta zgjidhim problemin, do të arrijmë t'i kapim edhe perspektivat e këtyre vendimeve", thotë Zaev.

2018-ta, kyç për zgjidhjen e emrit

Strugë, 2 shkurt - Ekziston optimizëm i arsyeshëm se pikërisht në vitin 2018 do të tejkalohet problemi që Greqia e ka me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Këtë të premten nga Struga e porosit zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane Bujar Osmani. "Jemi optimistë se yjet janë vendosur ashtu që vetëm viti 2018 jep mundësi për depërtim konkret. Veç më vitin

2019 do të jetë vit i humbur për shkak të kësaj që ka zgjedhje në BE për Parlamentin Evropian dhe nuk mund të pritët që shtetet evropiane të fokusohen në Ballkan. Krahas kësaj zgjedhje ka edhe në Greqi dhe tene. Duhet të jemi të sinqertë para qytetarëve dhe t'u themi se nëse e lëshojmë këtë shans në dhjetë vitet e ardhshme nuk do të mund të gjejmë zgjidhje", theksoi Osmani.

Ai tregoi në pasojat negative potenciale për çfarë ato do të thonin për, siç tha, "një shtet i vogël jashtë NATO-s dhe BE-së në këso rrethanash gjeopolitike". "Do të duhet të gjithë seriozisht të mendojmë. Përgjegjësia jonë si politikanë është që ta garantojmë ardhmërinë e shtetit dhe të gjeneratave që vijnë. Nuk guxojmë të udhëhiqemi nga emocione ditore por ta çojmë shtet-

in përpara. Është vështirë, absolutisht, por jemi të vetëdijshëm për rrethanat dhe mundësitë që i ofron viti 2018", theksoi Osmani. Zëvendëskryeministri tha se në këtë rast duhet të llogaritet për ndjeshmërinë rreth çështjes për të dyja palët. "Zgjidhje e qëndrueshme mund të jetë vetëm kjo që është e pranueshme për të dy shtetet, dhe për këtë këto negociata, prej atje këto kom-

promise. Nimic dha propozim, ne ndërtojmë konsensus shtetëror për qëndrim si përgjigje të propozimit. Kuptohet se kemi edhe çështje tona të ndjeshme rreth kësaj megjithatë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e momentit dhe do të mund të gjejmë një zgjidhje të pranueshme reciproke që do ta mbajë dhe ruajë dinjitetin e të dy shteteve", shtoi Osmani.

Shekerinska potencoi se Maqedonia respekton qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare që transformimi duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, duke shtuar se Maqedonia do ta ndihmojë Kosovën për të gjitha ato hapa që do të ndërmerren gjatë këtij procesi

Prishtinë, 2 shkurt - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska, e cila po qëndron për vizitë zyrtare në Kosovë, deklaroi se Maqedonia respekton qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forcat të Armatosura duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Shekerinska, e cila u prit me ceremoni ushtarake në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), ka realizuar një takim me ministrin e FSK-së, Rrustem Berisha i cili ka qenë i mbyllur për media. Pas këtij takimi është mbajtur edhe takimi i përbashkët në mes dy delegacioneve. Në konferencën e përbashkët për media, duke theksuar se krahas vizitës së sotme e cila është e para në Prishtinë, Shekerinska tha se kanë patur takime të ndryshme jashtë vendit me ministrin Berisha. Ajo tha se këto takime janë dëshmi që tregojnë vendosmërinë e të dyja qeverive në ndërtimin e marrëdhënive të mira fqinjësore. Lidhur me çështjen e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës, Shekerinska theksoi se puna e parë që duhet të bëjnë fqinjët është të ndihmojnë njëra tjetrën e jo të bëjnë të kundërtën. Ajo potencoi se Maqedonia respekton qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare që transformimi duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, duke shtuar se Maqedonia do ta ndihmojë Kosovën për të gjitha ato hapa që do të ndërmerren gjatë këtij procesi.

SHEKERINSKA NË VIZITË ZYRTARE NË KOSOVË

MAQEDONIA MBËSHTET USHTRINË E KOSOVËS



shkësisë ndërkombëtare që transformimi duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, duke shtuar se Maqedonia do ta ndihmojë Kosovën për të gjitha ato hapa që do të ndërmerren gjatë këtij procesi.

"Republika e Maqedonisë çdo herë e ka dëgjuar me vëmendje qëndrimin e Republikës së Kosovës, por edhe atë të bashkësisë ndërkombëtare. Ne e përkrahim qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare në drejtim të asaj se me të vërtetë duhet të merren parasysh të gjitha procedurat dhe situata politike dhe gjithë situata e ndjeshme në rajon. Për këtë arsye do të themi se ne e respektojmë qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare që thotë se duhet të respektohen rregullat dhe ndryshimet kushtetuese", tha Shekerinska. Ministri Berisha tha se gjatë takimit me ministrin Shekerinska

kanë diskutuar për kapacitetet e FSK-së duke vënë theksin tek dëshira për të qenë kontribuues proaktiv të sigurisë e jo vetëm konsumues të saj. Sa i përket objektivave për procesin e zgjerimit ose ndryshimit të misionit të FSK-së, ministri Berisha tha se ka njoftuar ministrin Shekerinska për përpjekjet e FSK-së "që të jetë një forcë multietnike, forcë profesionale e cila do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve". "Synimi ynë si FSK-së është anëtarësimi dhe integrimi në NATO. Sa i përket bashkëpunimit rajonal jemi të interesuar që të avancojmë bashkëpunimin me të gjitha shtetet që janë pjesë e NATO-s dhe të tjerat që aspirojnë të jenë në NATO. Në kuadër të kësaj biseduam edhe rreth hapave të bashkëpunimit konkret në këtë drejtim, megjithatë jam i bindur që ky bashkëpunim do të avancohet edhe më shumë në të ardhmen.

Kemi shumë arsye që t'i ndërtojmë kapacitetet e përbashkëta që bashkërisht t'i luftojmë fenomenet negative që mund ta rrezikojnë ambientin e sigurisë qoftë ato rajonale, qoftë ato globale", tha Berisha.

Berisha poashtu deklaroi se bashkëpunimi i dy vendeve në fushën e sigurisë është i fokusuar në fushën e arsimit të kuadrove dhe stërvitjeve. Duke theksuar se gjatë takimit dy ministrat kanë biseduar për mundësitë e shfrytëzimit të kapaciteteve të përbashkëta, ministri Berisha falënderoi ministrin Shekerinska për mundësinë e shfrytëzimit të kampit veror në Kriivolak të Maqedonisë. Ai, poashtu shprehu falënderimet edhe për pjesëmarrjen e kontigjentit të Maqedonisë në ushtrimin fushor "Shqiponja 6", e cila do të mbahet në Kosovë në muajin maj. Shekerinska është pritur edhe nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj.

Shumica për ndryshimin e emrit

Shkup, 2 shkurt - Zgjidhjen e problemit me emrin me qëllim të hyrjes sa më të shpejtë të Maqedonisë në BE dhe në NATO e mbështesin 61 për qind e qytetarëve të Maqedonisë (43 tërësisht, ndërsa 18 për qind deri diku), tregojnë rezultatet e anketës telefonike në 1.000 të anketuar e zbatuar prej 19 deri më 26 janar nga M-Prospekt për Institutin për Demokraci Societas Civilis Shkup. Mbështetje për ndryshimin e emrit me qëllim të hyrjes në BE dhe NATO kanë shprehur 50 për qind e maqedonasve (30 për qind tërësisht, ndërsa 20 deri diku), ndërsa 95 për qind e shqiptarëve (84 tërësisht, ndërsa deri diku 11 për qind). Në pyetjen nëse me ndryshimin e emrit do të ndryshojë edhe rëndësia e asaj çfarë është Maqedonia dhe populli maqedonas, 34 për qind janë përgjigjur se tërësisht do të ndryshojë, 19 se deri diku do të ndryshojë, 33 për qind se aspak nuk do të ndryshojë, ndërsa katër për qind se deri diku nuk do të ndryshojë. Për 60 për qind të maqedonasve të anketuar me ndryshimin e emrit do të ndryshojë edhe identiteti (për 40 për qind tërësisht, ndërsa për 20 deri diku), ndërsa 35 për qind e konsiderojnë të kundërtën. Tek shqiptarët 30 për qind vlerësojnë se do të ndryshojë (13 tërësisht, ndërsa 17 pjesërisht), ndërsa 48 për qind janë se identiteti aspak nuk do të ndryshojë dhe 10 për qind plotësisht se deri diku nuk do të ndryshojë.

MUIZHNIKSI PREZANTOI RAPORTIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NDARJE TË MËDHA ETNIKE DHE GJUHËSORE

"Shoqëria e Maqedonisë mbetet thellë e ndarë sipas bazave etnike dhe gjuhësore dhe koha e fundit është që liderët politik të mendojnë strategji për integrim të tejkalimit të këtyre ndarjeve", konsideron komisar i drejtat e njeriut i KE-së, Nills Muizhnieks

Shkup, 2 shkurt - Komisar i drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, Nills Muizhnieks, të premten në konferencë për shtyp theksoi se autoritetet e Maqedonisë duhet të zbatojnë politika që nxisin integrim dhe mirëkuptim mes bashkësive etnike dhe të promovojnë kohezion social, njëkohësisht duke e mbrojtur diversitetin. Muizhnieks, i cili është për vizitë pesëditore në Maqedoni, tha se Marrëveshja e Ohrit i ka dhënë fund

konfliktit në vitin 2001 dhe solli deri te ndryshimet në rajone të caktuara, si përfaqësimi juridik i bashkësive, decentralizimi dhe përdorimi i gjuhëve, por, megjithatë kohezioni social nuk është arritur. "Shoqëria e Maqedonisë mbetet thellë e ndarë sipas bazave etnike dhe gjuhësore dhe koha e fundit është që liderët politik të mendojnë strategji për integrim të tejkalimit të këtyre ndarjeve", konsideron komisar i drejtat e njeriut. Fëmijët në Ma-

qedoni, sipas tij, vonë fillojnë t'i mësojnë gjuhët e bashkësive tjera. Për shembull, potencoi ai, fëmijët shqiptar gjuhën maqedone fillojnë ta mësojnë madje në klasën e katërt, ndërsa nëse dikush nga fëmijët maqedonas dëshiron ta mësojë gjuhën shqipe atë do të mund ta bëjë nga klasa e gjashtë.

Muizhnieks duke iu përgjigjur pyetjes në lidhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve me të cilin përparohet përdorimi i gjuhës shqipe,

tha se ka dëgjuar shumë vlerësime të ndryshme për këtë tekst dhe se për momentin ai paraqet ndarje kyçe mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Në pritje jam të mendimit të Komisionit të Venecias, thotë ai, por ai jep vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit, e nuk do ta vlerësojë kohezionin social dhe inkluzivitetin. Komisar i drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës tha se nuk i ka vizituar të burgosurit lidhur me ngjarjet dhe dhunën më



27 prill në Parlament. Tha se persona tjerë nga Këshilli i Evropës i kanë vizituar dhe se kushtet në burg janë të këqija. Kjo çështje është ngritur në Parlament ku janë potencuar konkluzionet e avokatit të popullit në raport të ndjekjes së procedurave. Ai potencoi se masa e paraburgimit nuk duhet të shfrytëzohet si dënim, por vetëm nëse ekziston ndonjë rrezik. (E.H)

DHUNA NË KOMUNËN QENDËR



“SHUPLAKAT” NISIN NGA E PARA

Procesi gjyqësor për dhunën e ushtruar në Komunën Qendër, nga simpatizant dhe aktivistë të VMRO-DPMNE-së, në qershor të vitit 2013, edhe pas dy viteve ajo vazhdon të zvarritet

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 2 shkurt - Ndryshimet në Këshillin Penal për rastin “Shuplakat”, ishin arsyeja kryesore se pse kjo lëndë të premtën filloi të procedohet nga e para në Gjykatën Penale të Shkupit. Kryetari i ri i Trupit gjykues, Dushan Josifovski, tha se Ligji për procedurë penale, doemos e parasheh nisjen e procesit nga e para, me këtë edhe leximin e propozim akuzës dhe prezantimit të dëshmitë. Prokurorja speciale, Fatime Fetaj, i propozoi palës mbrojtëse të akuzuarve, në këtë rast Nikolla Gruevski dhe të tjerëve, që leximi i akuzës mos të lexohet për të dytën herë, për shkak se të njëjtit i kanë të qartë vepra për të cilat ngarkohen. Megjithatë, ata insistuan që propozim akuzës të lexohet përsëri.

“Meqë diapozitivin e aktakuzës po e lexojmë për të dytën herë, atëherë të theksohet se kur të lexohet emri i Tomisllav L Lazarotiv apo Jordan Ristevskit, të nënvizohet se njëjtit më janë të dënuar, gjegjësisht për të akuzuarin Dimçe Ri-

stevski, të potencohet se për të njëjtën ngjarje, procesi gjyqësor të zhvillohet ndaras”, tha, prokurorja Fetaj.

Pas këtij precizimi të propozim akuzës, ajo vazhdoi dhe tregoi se si ka rrjedhur organizimi i sulmit në Komunën Qendër në qershor të vitit 2013, me çka si organizator kryesor e cilësoi ish kryeministrin Nikola Gruevski dhe ish ministrin e transportit dhe lidhjeve, Mile Janakievski. Njëri avokatëve të Nikolla Gruevski, ish kryetari i Prokurorisë së Shkupit, Sterio Zikov, pas përfundimit të leximit të propozim akuzës nga prokurorja Fetaj, ai tha se nuk e ka të qartë se në çfarë mbështet kjo akuzë e Prokurorisë Speciale Publike.” Atë që lexuat ju është akuzë jo ligjore dhe jo konkrete. Dispozitivi i akuzës duhet të jetë i plotë dhe kur ndryshohet. Përfaqësuesit e akuzës sot duhet të dorëzojnë akuzë të re, duke i potencuar të gjitha ndryshimet që janë bërë brenda kohës”, tha, avokati Zikov.

Vërejtjet dhe kundërshtimet e njëpasnjëshme të palës

mbrojtëse, në rastin “Shuplakat”, për arsye të ndryshme duke filluar nga mënyre e përpilimit të procesverbalit, listën e dëshmitë e kështu me radhë, prokurori special, Gavril Bubevski i cilësoi si tendencë për të zvarritur procesin gjyqësor dhe asgjë më tepër. Procesi gjyqësor për dhunën e ushtruar nga Komunën Qendër, nga simpatizant dhe aktivistë të VMRO-DPMNE-së, në qershor të vitit 2013, ndonëse para Gjykatës Penale të Shkupit, u propozua të shqyrtohet si propozim akuzë, e cila parasheh një procedurë të shkurtë, të shpejtë dhe efektive për zbardhjen e rastit, megjithatë edhe pas dy viteve ajo vazhdon të zvarritet. Paraprakisht, gjykatësja e këtij rasti, Tatjana Mihajlova, e cila me sistemin e ri të gjykatësve, në GJPSH-së procedon lëndë për kundërvajtje, seancat gjyqësore për sulmin ndaj Komunës Qendër, shpesh herë i prolongonte pa ndonjë arsye bazë. Lidhur me këtë çështje, PSP vitin e kaluar inicioi procedurë për shkarkimin e saj nga kjo lëndë, mirëpo e njëjta u re-

fuzua, me çka anulimi i seancave për këtë lëndë vazhdoi edhe gjatë vitit 2017, deri në largimin e saj nga Sektori për shqyrtimin e lëndëve nga krimi i organizuar. Ndryshe, për momentin si të akuzuar për rastin “Shuplakat” hetohen gjithsej 11 të dyshuar, të cilët përmes britmave dhe ofendimeve pasditen e 7 qershorit të vitit 2013, e kanë sulmuar Këshillin komunal në Qendër të Shkupit, duke e pamundësuar zhvillimin e mbledhjes së rregullt. Lista e dëshmitë e propozuan nga PSP-ja, në rend të parë është parashikuar të prezantohet me rrëfimin e dëshmitarëve, në këtë rast ish kryetari të Komunës Qendër, Andrej Zhernovski, dhe bashkëpunëtorëve të tij. Sidoqoftë, mbetet të shihet se vallë Zhernovski, do të duhet të prezantohet edhe njëherë në cilësinë e dëshmitarit, apo vetëm do të lexohet deklarata e tij e dhënë para Trupit gjykues muaj më parë, ku mes tjerash shtoi se policia e ka ndihmuar sulmin ndaj Komunës Qendër.

KRONIKË

Në Tabanoc ndalohej kontrabandim me stoli ari

Një shtetas i Maqedonisë ka tentuar të fusë stoli ari në vlerë rreth 30 mijë euro në vendkalimin kufitar Tabanoc. Nëpunësit doganorë gjatë kontrollit personit T.M., në xhepin e majtë dhe të djathtë të xhupit të tij kanë gjetur stoli ari të paparaqitur, dy lira dhe një orë dore ROLEX-TUDOR, të mbështjella dhe të lidhura në çorape. Sipas ekspertizës së parë, vlera e stolive të arit vlerësohet mbi 29 mijë euro. Inspektorët e Sektorit për hetime në kuadër të Drejtorisë Doganore ndërmorën masa paratimore dhe aktivitete dhe është përcaktuar se i dyshuari stolinë e arit e ka blerë nga Italia ku përkohësisht jeton dhe punon, me çmim prej 20 euro për një gram. Kundër të dyshuarit në PPTH - Kumanovë është dorëzuar padi penale për veprën e kryer penale “Kontrabandim”. I dyshuari i është dorëzuar gjykatësit në procedurë paraprake në Gjykatën Themelore - Kumanovë ku është shqiptuar masa e kujdesit - marrja e dokumenteve të udhëtimit.

Vidhet një postier në Shkup

Një i maskuar ka grabitur një postier 47-vjeçar nga Shkupi, A.F. i punësuar në SHA “Postat e Maqedonisë”. MPB njoftoi se grabitja ndodhi dje rreth orës 10 në rrugën “Brigada maqedonase-kosovare” në komunën e Çairit. Duke iu kanosur me pistoletë, autori nga A.F. i ka marrë çantën ku ka pasur rreth 15.000 dhe 20.000 denarë dhe është larguar në drejtim të panjohur. Merren masa për gjetjen e autorëve dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Rrahet rëndë 32-vjeçari nga Gjermania

Të enjten mbrëma rreth orës 19 e 30 minuta në Spitalin Klinik të Tetovës është sjellur 32 vjeçari A.I nga fshati Gjermë me lëndime në kokë dhe fytyrë. Sipas policisë, në rrugën “Bllagoja Toska” në Tetovë është takuar me dy persona të panjohur, të cilët pa asnjë arsye - fizikisht e kanë sulmuar duke e goditur me grushte dhe i kanë shkakuar thyerje të hundës dhe lëndime tjera të dukshme. Janë marrë maza për zbardhjen e plotë të rastit.

Aksident në autostradë, dy të lënduar

Në autostradën Shkup-Tetovë, të enjten mbrëma rreth orës 20, një veturë e tipit Ford Eskort me targa të Tetovës, e drejtuar nga 33 vjeçari F.D nga fshati Poroj ka humbur kontrollin, ka dalur nga rruga dhe ka përfunduar jashtë autostradës.

Me këtë rast, vozitësi dhe bashkudhëtarja A.D, 65-vjeçare, kanë marrë lëndime trupore dhe me veturë tjetër janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës ku u është dhënë ndihmë mjekësore. Vozitësi është lëshuar për mjekim shtëpiak, kurse bashkudhëtarja është mbajtur për shërim në spital. Sipas policisë, shkak për këtë aksident ka qenë mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë.

Sundimi i së drejtës, Maqedonia në vendin e 57

Shkup, 2 shkurt - Në botë është vërejtur rënie e përgjithshme e sundimit të së drejtës, veçanërisht të të drejtave themelore të njeriut, tregon analiza më e mirë e projektit botëror të drejtësisë. Sipas indeksit të

sundimit të së drejtës, në listën e 133 shteteve nga e gjithë bota, Maqedonia radhitet në vendin e 57-të. Më keq e radhitur nga shtetet e rajonit është Serbia, e cila gjendet në vendin e 76-të. Ndërsa më mirë e

vlerësuar nga vendet ballkanike është Sllovenia, e cila ndodhet në vendin e 26-të, më pas Rumania në vendin e 29-të, Kroacia e 35-ta. Sipas sundimit të së drejtës, Shqipëria është e 68-ta, Bullgaria e 55-

ta, Bosnja e Hercegovina e 56-ta, ndërsa Mali i Zi dhe Kosova nuk janë përfshirë në hetime. Globalisht në vendin e parë sipas sundimit të së drejtës është Danimarka, më pas Norvegjia, Finlanda dhe Suedia.

PËR ZHVILLIMIN E FËMIJËVE DHE CILËSINË E MËSIMIT

LIBRI DHE FAMILJA MË TË RËNDËSISHME SE ÇERDHE

Institucionet e arsimit parashkollor, sigurisht se kanë rol pozitiv për shkollimin e mëtejshëm të fëmijëve. Por nuk ka asnjë tezë të mbështetur shkencërisht se janë më të rëndësishëm se familja, thotë Elizabeta Bajrami Ollogu, profesoreshë e UNT-së

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 2 shkurt - Është bërë thuajse e zakonshme që nëpër studimet e ndryshme për cilësinë në arsimin fillor shkaqet për performancat e dobëta të kërkohen në mosfrekuencimin e institucioneve të parashkollore. Për të argumentuar këtë, shfrytëzohen çdoherë të dhëna që flasin për përfshirje jo shumë të lartë të fëmijëve nëpër kopshte dhe çerdhe. Megjithatë, studime të tjera flasin se argumenti i ndjekjes ose jo të arsimit parashkollor nuk mjafton për të mbështetur tezën se ky është faktor i rëndësishëm për cilësinë e mësimin, sidomos të nxënësve të ciklit të ulët të arsimit fillor. Kopshtet dhe çerdhet, sipas një pjese të mirë të ekspertëve të fushës, nuk janë më të rëndësishme se familja dhe biblioteka. Madje, këta të fundit, sikurse shprehet Elizabeta Bajrami Ollogu, profesoreshë në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, janë faktorë të cilët kanë impakt shumë më të madh në socializmin e fëmijëve dhe zhvillimin e aftësive kognitive të tyre krahasuar me kopshtet dhe çerdhet. Institucionet e arsimit pa-

rashkollor, thotë më tej ajo, sigurisht se kanë rol pozitiv, por nuk ka asnjë tezë të mbështetur shkencërisht se janë më të rëndësishme se familja. Përkundrazi, shumë sociologë ndajnë mendimin se familja, respektivisht ambienti familjar janë shumë më të ndikueshëm në zhvillimin e fëmijëve se sa çerdhet.

"Në një familje ku libri është pjesë e përditshmërisë, ku flitet me respekt për shkollën dhe ku vijnë në shprehje pretendimet e prindërve për konsumim të dijeve dhe njohurive, është shumë e natyrshme që gjithë kjo klimë pozitive që krijohet në familje për librin dhe shkollën të reflektojë te fëmijët duke krijuar një shtesë të dallueshme në zhvillimin psikologjik të fëmijëve", sqaron profesoresha Ollogu. Prandaj, është shumë e rëndësishme që fëmijët të familjarizohen me librin që në shtëpi. E, kur ky familjarizim vjen në mënyrë të natyrshme, spontane, u krijojmë atyre shumë më tepër lehtësira në krijimin e shprehive për mësim dhe paralelisht kësaj edhe në prirjet për ta konsideruar librin "shokun më të mirë". Të gjitha këta faktorë, pa injoruar edhe cilësinë e kopshteve,

shkollave apo mundësive që u krijohen fëmijëve për shkollimin e mëtejshëm, sipas saj ndikojnë në cilësinë e arsimit të përgjithshëm. Madje në një hulumtim të bërë disa muaj më parë nga UNT-ja për lidhjet mes arsimit parashkollor me arsimin fillor nuk kishte asnjë tregues bindës se nxënësit e përfshirë nëpër çerdhe dhe kopshte janë më të suksesshëm se ata që nuk kanë qenë përfshirë në arsimin parashkollor. "Një arsye për këtë mund të jetë edhe niveli i përkushtimit të edukatorëve viza-vijë përkushtimit të mësimdhënësve, ashtu sikurse edhe kushtet dhe cilësia që ofrojnë kopshteve tona.

Kjo mbetet për tu analizuar në hulumtime të tjera", shpjegon Ollogu, e cila kishte udhëhequr me atë hulumtim të realizuar në tre shkolla fillore të Shkupit. Por, për gjetje të përafërta flasin dhe hulumtime nacionale, me përfshirje të lartë të shkollave fillore, siç është ai i Fondacionit për iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi" në Maqedoni. Në këtë hulumtim, ku janë përfshirë 8000 nxënës të 336 shkollave fillore del se numri më i madh i faktorëve që ndikojnë

në cilësinë e mësimin te nxënësit e ciklit të ulët kanë lidhje të drejtpërdrejta me shtëpinë. Konkretisht, nga shtatë faktorët e evidentuar lidhur me çështjen e cilësisë pesë kanë të bëjnë me familjen dhe dy me shkollat. Në rend të parë, qendron shkalla e arsimit të prindërve, pastaj nëse mësimi ndiqet në shkolla urbane apo rurale, nëse nxënësi ka ndjekur arsim parashkollor, nëse ka krijuar shkathtësi të zhvilluara për lexim para se të regjistrohet në klasë të parë, nëse shtëpia e banimit ka ose jo bibliotekë, nëse huazohen ose jo librave nga biblioteka të tjera (të qytetit ose shkollës) si dhe nëse nxënësit kanë traditë leximi në shtëpi, qoftë në mënyrë të pavarur apo me dikë tjetër. Gjetja e këtyre faktorëve tregon se familja dhe libri, krahas shkollës janë faktorët kryesor që ndikojnë në cilësinë e mësimin të nxënësve. As ky hulumtim nuk përjashton përfshirjen në institucionet e arsimit parashkollor si faktor relevant. Por ai nuk është as i vetmi dhe as më i rëndësishmi në zhvillimin e fëmijëve dhe qasjen që do të kenë ndaj mësimin.



Mickoski kërkon dialog politik

Shkup, 2 shkurt - Nevojitet dialog politik për tejkalimin e dallimeve lidhur me proceset kryesore në vend, ndërsa për këtë nevojitet vullnet nga shumica qeveritare, theksoi lideri i VMRO-DPMNE-së Hristijan Mickoski në takim me eurodeputet nga grupi i Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Evropian, Viktor Boshtinaru, Tanja Fajon dhe Tonioni Picula. Në takim, siç citohet në njoftimin nga VMRO-DPMNE-ja, u bisedua për gjendjet aktuale politiko-shoqërore dhe prioritetet strategjike në Republikën e Maqedonisë për anëtarësim në BE dhe në NATO. Mickovski theksoi se VMRO-DPMNE-ja është e gatshme që të përrahë çdo zgjidhje dhe proces reformativ për të cilin vlerëson se është në interes të vendit dhe përforsimin e proceseve demokratike, nëse është në interes të të gjithë qytetarëve të RM-së. Në takim, sipas njoftimit, Mickoski theksoi se pushteti aktual zbaton përndjekje të qytetarëve si dhe të deputetëve nga partia e tij. Sipas Mickoskit, akti i tillë nuk e çon përpara vendin dhe e vështirëson procesin demokratik.

DESKOSKA LAVDËRON STRATEGJINË PËR ARSIM

Mësimi i integruar ndalon rrahjet ndëretnike të nxënësve

Shkup, 2 shkurt - Incidentet midis të rinjve janë rezultat i ndërtimit të atmosferës së padurimit, nacionalizmit dhe urrejtjes ndëretnike, që ishte përditshmëri në të kaluarën dhe e nxitur nga funksionarët më të lartë shtetëror, por Qeveria e tanishme përpiket ta promovojë dhe ta zgjerojë konceptin jetë për të gjithë, të jetuarit së bashku të të gjithë bashkësive etnike, deklaroi ministrja e Arsimit dhe Shkencës Renata Deskoska lidhur me rrahjen e një dite më parë midis dy grupeve të minorenëve. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve pas ndarjes së granteve nga fondi "Ndërtojmë ura", Deskoska theksoi se mësimi i të rinjve për tole-

rancë dhe bashkëjetesë midis dalueshmëri është edhe një nga masat në Strategjinë për arsim 2018-2025 e cila është miratuar të martën në seancë të Qeverisë. "Si Ministri mbështesim projekte që do të thonë afrim ndëretnik i të rinjve nga grupe të ndryshme etnike. Në Strategji janë paraparë masa të cilat do të thonë ndërtim i bashkëjetesës dhe mësimi i të rinjve se kjo është ardhmëria e Republikës së Maqedonisë", theksoi Deskoska. Ajo shpjegoi se në konceptin e programeve mësimore do të futen elemente për njohje të dallueshmërive, komponenti multi-etnik do të futet edhe në libra dhe në plan-programet mësimore,

ndërsa për ndërtim të bashkëjetesës do të sigurohen edhe kushte hapësimore, gjegjësisht të gjithë nxënësit të mësojnë në ndërtesa të njëjta shkollore. "Në disa komuna, për shembull në Tetovë dhe Kumanovë, nxënësit në gjuhën maqedonase mësojnë në një ndërtesë, ndërsa nxënësit të cilët mësojnë në gjuhën shqipe mësojnë në ndërtesë tjetër. Ata janë fizikisht të ndarë, që nuk është praktikë e mirë. Bëjmë përpjekje me kryetarët e komunave që të sigurohen të gjithë dokumentacionet projektuese dhe lejet për ndërtim me qëllim që t'i rrënojmë fillimisht këto barriera fizike. Të shihet se kur mësojnë së bashku,

në një shkollë, kjo mund të jetë pozitive, e jo burim i tensioneve dhe konflikteve", tha ministrja e Arsimit. Krahas integritetit ndëretnik, Strategjia për arsim ka aktivitete të cilët i përfshijnë të gjithë komponentët të procesit arsimor - parashkollor, arsim fillor, mesëm, i lartë dhe mësimi i përgjithshëm, të cilët janë të strukturuar në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2025. Disa komponentë, tha Deskoska, u dedikohen të gjithë niveleve arsimore, si për shembull sigurimit të qasjes të barabartë deri te arsimi për të gjithë, duke i përfshirë fëmijët me nevoja të posaçme, si dhe ngritjen e cilësisë së arsimit. Në arsimin e mesëm vë-



mendje i kushtohet arsimit profesional i cili, tha ministrja, në periudhën e kaluar ishte marginalizuar dhe lënë anash. Qëllimi është që arsimi i mesëm profesional të lidhet me biznes-bashkësinë me qëllim që të krijohen plane mësimore të cilët do t'u përshtaten nevojave të tregut të punës.

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër publikon:

SHALLJE PUBLIKE

Për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.12.2018 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër publikon shpallje për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të caktuar për pozitën në vijim:

1. Punëtor i diplomuar social – 1 (një) realizues;
2. Psikolog – 1 (një) realizues;
3. Pedagog – 1 (një) realizues;
4. Motër medicinale – 1 (një) realizues;

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër (për të gjithë kandidatët):

të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;

Të jetë i moshës së rritur;

Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

Kandidati për vendin e punës me numër 1, punëtor i diplomuar social duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të arsimit dhe së paku 2 vjet përvojë pune në institucione për mbrojtje sociale,

Kandidati për vendin e punës me numër 2, psikolog duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të arsimit dhe së paku 2 vjet përvojë pune në institucione për mbrojtje sociale,

Kandidati për vendin e punës me numër 3, pedagog duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të arsimit dhe së paku 2 vjet përvojë pune në institucione për mbrojtje sociale, dhe

Kandidati për vendin e punës me numër 4, motër medicinale duhet të ketë të mbaruar shkallën e IV të arsimit, pa përvojë pune,

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitën e punës, duhet të parashtojnë dokumentet në vijim:

Dëshmi të shtetësisë;

Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.

Biografi të shkurtër;

Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40,

koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është:

1. Për vendet e punës me numër 1, 2 dhe 3 - 23.176,00 denarë,

2. Për vendin e punës me numër 4 - 13.616,00 denarë.

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar.

Punësimi është në kohëzgjatje deri më 31.12.2018.

Afati në të cilin do të bëhet përzgjedhja është 45 ditë.

Afati për parashtimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të fundit të shpalljes.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër, ose përmes postës në adresën në vijim: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër

rr. "Atanas Iliq" nr. 45 - 1250 Dibër

Departamenti për resurse njerëzore

(me shenjë "për shpallje")

Personi për kontakt

Kontakt telefoni 046 831 400

Fletëparaqitjet e parashtuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Dibër



Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vijim publikon


KORRIGJIM

**Të shpalljes publike për emërim të drejtorëve
dhe zëvendës drejtorëve në pajtim
me ligjet e veçanta materiale**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë më datë 31.01.2018 ka publikuar shpallje publike në gazetën ditore "Sloboden Peçat", "Nova Makedonija" dhe "Koha", për emërim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në të cilën bëhet korrigjim në pikën 6 ashtu që teksti zëvendësohet me të ri, i cili është si në vijim:

"Afati për paraqitje të kandidatëve të interesuar është 15 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore, ndërsa afati për paraqitje të kandidatëve për Shpalljen publike për emërim të drejtorit të Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes".

Ky korrigjim ka të drejtë veprimi nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetën ditore më datë 31.01.2018.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 - tekst i pastruar), nenit 60 paragrafi 2 të Ligjit për arsim të mesëm dhe Pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-11025/3 të datës 12.12.2017 dhe Korrigjimit të pëlqimeve të miratuara nr. 10-2077 të datës 11.01.2018, SHMNGJ QSH "Zdravko Cvetkovski" - Shkup, publikon:

SHALLJE PUBLIKE

Për punësim të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

PUBLIKOHET, shpallje publike për punësim të mësimdhënësve për kohë të caktuar të punës - financim i vjetër deri më 31.08.2018 për vendet e punës në vijim:

BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL PËR MËSIMIN NË GJUHËN MAQEDONASE

1. Defektolog - 1 realizues 40 orë punë me neto pagesë fillestare prej 21.522,00 denarë

MËSIMI NË GJUHËN SHQIPE

2. Mësimdhënës të lëndëve profesionale nga ndërtimtaria - 1 realizues 20 orë mësimore me neto pagesë fillestare prej 21.522,00 denarë.

3. Mësimdhënës të gjuhës shqipe - 1 realizues 10 orë mësimore me neto pagesë fillestare prej 10.761,00 denarë.

Kandidatët krahas kushteve themelore të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me nenin 59 të Ligjit për arsim të mesëm dhe Normativin për kuadrin mësimor dhe bashkëpunëtorëve profesional në arsimin e mesëm.

Orari i punës është caktuar në pesë ditë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte, në pajtim me Orarin për vitin shkollor 2017/2018. Orari ditor i punës mbahet në dy ndërrime edhe atë: Ndërrimi i parë prej ora 07.30 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.30 deri në ora 19.30.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Lutje (fletëparaqitje)

- CV,

-Diplomë ose Certifikatë për arsimin e mbaruar përkatës;

-Certifikatë për derikualifikim pedagogjik-psikologjik dhe metodik (për mësimdhënësit të cilët nuk kanë mbaruar grupin mësimor të studimeve);

-Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje në lidhje me shpalljen.

Dokumentet e nevojshme të parashtohen deri në SHMNGJ të Qytetit të Shkupit "Zdravko Cvetkovski" - Shkup, bulevardi "Partizanski Odred" nr. 91, 1000 Shkup, përmes postës rekomanduese ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës. Dokumentet e pakompletuara, të parregulluara dhe të dorëzuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

Kontakt personi për shpalljen publike është Verica Hristovska, kontakt telefoni 02/3062-694 dhe kontakt e-mail adresa kontakt@zdravkocvetkovski.edu.mk.

SHMNGJ QSH "Zdravko Cvetkovski" - Shkup
DREJTOR,
Dragica Kostadinovska

I. Nr. 324/2014

SHALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përmbardim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përmbarduesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditorit Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoc - Poroj nr. 8, kundër borxhliut Husein Memedi nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenski Pish nr. 69, dhe borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenski nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000,00 denarë më datë 26.01.2017

FTON
Borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenski nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përmbarduesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtim të akteve në vijim: Konkluzion për shitje publike me gojë i nr. 324/2014 të datës 15.01.2018, Konkluzion për përcaktim të vlerës nga data 15.01.2018 dhe Konkluzion për mënyrën e shitjes së patundshmërisë i nr. 324/2014 të datës 15.01.2018. NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këtillë e dorëzimit llogaritet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet PUBLIKIMIN E GJASHTË të thirrjes publike

PËRMBARUES
Vanço Markovski

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Koha <http://www.koha.mk>

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I.Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhese, Shkup

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

ZBRITJE DERI NË 30%

CENTAR ZA GUMI

**MICHELIN
DUNLOP
VIKING
SPORTIVA**

**NË RRUGEN E PLASTIKAVE PËRBALL MARMARIS.
Kontakt Tel: 070-222-388, 071-263-723 dhe në facebook CentarZaGumiHR**

RRJETI I VJETËR I UJËSJELLËSIT SHKAKTON TELASHE



Qyteti i Tetovës ka një rrjet të vjetër të ujësjellësit kryesor gati se 50 vjet dhe defektet në pjesë të ndryshme të qytetit të Tetovës janë të zakonshme në të gjitha periudhat e vitit

DEFEKT NË RRJETIN KRYESOR, TETOVA PA UJË

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 2 shkurt - Një defekt në rrjetin kryesor të ujësjellësit të Tetovës ka bërë që mëngjesi i ditës së sotme të gjejë pjesën dërmuese të qytetit të Tetovës pa ujë. Defekti është detektuar në lagjen Çarshia e Epërme në Tetovë, ku edhe kalon gypi kryesor i ujësjellësit për furnizim të qytetit me ujë të pijshëm. Ekipet e njësisë "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" në kuadër të Ndërmarrjes Publike Komonale Tetova-Tetovë që nga orët e mëngjesit kishin dalë në vendngjarje dhe punonin në sanimin e defektit. "Kemi një defekt në gypin kryesor të ujësjellësit të Tetovës (fi 400) që furnizon me ujë qytetin e Tetovës në Lagjen Çarshia e Epërme. Për këtë arsye, gati se 70

për qind e qytetit të Tetovës nuk ka ujë të pijshëm. Ekipet tona janë duke tentuar që të sanojnë defektin e shkaktuar dhe besojmë se brenda ditës do të sanohet defekti dhe sërish do të kemi furnizim normal me ujë të pijshëm për qytetin e Tetovës", tha Samedin Abedini, udhëheqës i "Njësisë Ujësjellësi dhe Kanalizimi". Nga njësia "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" ende nuk kanë mundur të detektojnë se prej nga ka ardhur ky defekt në gypin kryesor, për shkak të shtypjes apo për shkak të vjetërsisë së rrjetit. "Ende nuk e kemi detektuar arsyen e defektit se është pasojë e rrjetit të vjetër, sepse i njëjti është i vjetër mbi 30 vite, apo është si pasojë e shtypjes së ujit. Jemi duke punuar në terren që të sanojmë defektin

dhe më pas mund të konstatojmë se cila ka qenë arsyeja e këtij problemi në rrjetin e ujësjellësit", tha Abedini. Në këtë kohë, në ditë ka rreth 30 defekte brenda 24 orëve, kurse në kohë normale ka 3-4 defekte në ditë. "Rregullisht ka defekte kurse më keq është kur ka rritje të sasisë së ujit në ujësjellës. Atëherë ndodhin defekte gjithandej në qytet. Kjo është sepse kemi një rrjet të instaluar në qytet të vjetër mbi 50-vjeçar. Gjatë kohës së rritjes së ujit, ky sistem nuk duron prurje më të mëdha dhe shkaktohen defektet. Në këtë periudhë regjistrohen edhe 30 defekte brenda një dite dhe ne si ndërmarrje nuk kemi kapacitete të sanojmë apo riparojmë këto defekte", deklaroi drejtori i

NPK-së në Tetovë, Xhelal Ceka. Ndryshe, qyteti i Tetovës ka një rrjet të vjetër të ujësjellësit kryesor gati se 50 vjet dhe defektet në pjesë të ndryshme të qytetit të Tetovës janë të zakonshme në të gjitha periudhat e vitit. Më vështirë është në muajt e parë të pranverës dhe në vjeshtë kur rritet sasia e prurjeve të ujit në sistemin e ujësjellësit dhe i njëjti nuk mund të mbajë sasi të mëdha të ujit dhe kjo bën që të ketë defekte të njëpasnjëshme në të gjitha pjesët e qytetit të Tetovës pa dallim. Sipas informacioneve zyrtare, ujësjellësi i parë për Tetovën është ndërtuar në vitin 1930 nga vendi i kaptazhit në afërsi të fshatit Shipkovicë me kapacitet prej 30 litra në sekondë. Ujësjellësi i dytë për qytetin e Tetovës është

Digat në Likovë të mbushura 81 për qind, Kumanova siguron ujin

Kumanovë, 2 shkurt - Ujë për qytetarët do të ketë edhe krahas asaj që nuk kishte reshje të borës dhe shiut në sasi të konsiderueshme në Kumanovë, thonë përgjegjësit nga Ujësjellësi "Fusha Kumanovë-Likovë". Kapacitetet e digave Likovë dhe Gllazhnja janë me rreth 80 për qind, gjegjësisht rreth 21 milionë metra kub nga kapaciteti i përgjithshëm i cili arrin 24 milionë metra kub. "Kapaciteti tani për tani është i mirë, varet prej kushteve të motit, në periudhën e dimrit kur mbushen digat dhe nëse nuk ka reshje deri në fund të prillit, sezonin do ta fillojmë me 80 për qind nga kapaciteti, që do të thotë se do të përmbushen nevojat e Ndërmarrjes Komonale dhe bujqve", deklaroi Oliver Ilievski, udhëheqës i "Fushës Kuamnovë - Likovë". Ndërmarrja ka siguruar 2,4 milionë denarë për investime, mjete të veta. Por, për intervenimet e mëdha, për sanimin e sistemit ekzistues dhe për ndërtimin e të riut, kompetentët e ndërmarrjes shprejnë në bashkëpunim me autoritete lokale, Ndërmarrjen Komonale dhe shtetin, me qëllim të zgjidhjes të përhershme të problemit me ujësjellësin në Kumanovë dhe Likovë. Ndërmarrja ka dorëzuar projekte deri te Qeveria dhe pret të ndahen mjete për programin investues dhe për sanim. Sa i përket problemit shumëvjeçar për çmimin e ujit të papërpunuar, i cili zvarritej me shumë se një dekadë, udhëheqësia e re e ndërmarrjes është e disponueshme për bashkëpunim me Ndërmarrjen Komonale i cili është konsumator më i madh. Nga Ujësjellësi, "Fusha Kumanovë-Likovë" thonë se kanë nevojë për kuadro profesionale për mirëmbajtjen e digave dhe punëtorëve për ndërmarrjen, për të cilën do të kërkojë pëlqim nga Ministria e Financave.

Fundjava me shi, dëborë dhe erë

Shkup, 2 shkurt - Shi dhe erë në viset më të ulëta dhe dëborë në viset malore, njofton DPHM për sot dhe nesër në Maqedoni. Sot moti do të jetë me vranësira me reshje të shiut, të cilat do të jenë më in-

tensive në orët e mërmjës. Më të rrëmbyeshme reshjet do të jenë në pjesët perëndimore, ku vendende do të bien mbi 35 l/m2. Reshjet e dëborës fillimisht do të ketë vetëm në viset më të larta

malore, ndërsa deri të dielën kufiri i dëborës do të bjerë deri rreth 1.500 metra lartësi mbidetare. Gjatë ditës së sotme do të fryjë edhe erë e përforcuar, në momente erë e fuqishme jugore me një

shpejtësi mbi 90 kilometra në orë. Të dielën paradite ende do të ketë reshje lokale, ndërsa deri në fund të ditës vranësirat do të pakësohen dhe do të paraqitet stabilizim i përkohshëm i motit.



AMIR DALIPI, KRYESHEF I RI I POLICISË NË TETOVË

Tetovë, 2 shkurt - Amir Dalipi është emëruar kryeshefi i ri i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Ai është emëruar në këtë post me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, një javë pas përmbylljes së konkursit për të parin e policisë së Tetovës. Konkursi ishte hapur pas shkarkimit të ish kryeshefit të Policisë, Nevahir Shabani. Lajmi

zyrtarisht nuk është bërë i njohur nga Sektori për Punë të Brendshme dhe as nga Ministria e Punëve të Brendshme, por është bërë i ditur nga vet tashmë kryeshefi i ri, Amir Dalipi në profilin e tij në Facebook, ku në fotografi duket me zëvendësministrin Agim Nuhiu. "Sot mora mbi supë detyrën e Kryeshefit të Sektorit për Punë të Brendsh-

me të Tetovës, jo për të bërë karrierë policore, por për të dhënë nga vetja gjithçka në të mirë të qytetarëve dhe vendit tonë. Lufta kundër të gjitha profileve të kriminit do të jetë e pa kompromis duke mos kursyer as edhe punonjësit e policisë. Askush nuk është mbi ligjin. Bashkë për një front të fuqishëm për siguri, dinjitet dhe perspektive", shk-

ruan në Facebook kryeshefi i ri i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Amir Dalipi në këtë post vjen nga Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe standarde profesionale në Stacionin Policor në Gostivar. Ai është i lindur në fshatin Senakos, shkollën e mesme e kreu në Gostivar kurse fakultetin në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Shqiptarët dhe tekstet shkollore

Nga Latif AJRULLAI



Reforma në arsimin parauniversitar e me theks të veçantë, ajo e teksteve shkollore në shkollat e Maqedonisë, është e pesta apo e gjashta në vazhdimësi. Dhe gjithmonë në formë eksperimentale, sepse eksperimenti nuk kishte të bënte me përmbajtjen lëndore të teksteve, por me mënyrën se si këto tekste të plotësonin nga pak dëshirat e të gjithë hartuesve apo prodhuesve të librave. Duke u nisur nga ky kriter aspak profesional, e kanë pësuar pikat më të rëndësishme të ligjit dhe të rregulloreve në procedurat e miratimit të teksteve dhe si rrjedhim, vetë përdoruesit, që janë nxënësit. Kështu derisa dikush në emër të këtyre fëmijëve ka përfutur materialisht, ata vetë kanë ngelur pa tekste ose kanë marrë tekste të cilësisë më të ulët (përkthime mjaft të këqija). Kjo dukuri negative, sidomos ka rënduar akoma më shumë nxënësit shqiptarë, për shkak se ata bashkë me mësuesit dhe prindërit e tyre, duke pasur statusin e qytetarit të rendit të dytë, janë detyruar të pranojnë çfarë u është servirur nga politika arsimore, dhe më keq akoma, u është dashur të mbyllin gojën dhe të falënderojnë eprorët apo shpëtimtarët politikë, që ua kanë mundësuar këtë, sepse mund të ishte edhe më keq. Maqedonasit kanë qenë të bindur se përfaqësuesit e politikës shqiptare janë të paditur dhe të padenjë për t'i pyetur për vendimmarrje. Kështu me vite është vendosur që librat do t'i bëjnë maqedonasit, si për vete njësoj edhe për shqiptarët "e paditur" dhe kjo po vazhdon edhe sot. Sot ka një kaos në drejtim të teksteve shkollore në Maqedoni. Edhe pse unë i takoj gjeneratave të vjetra të

intelektualëve, pedagogëve dhe arsimdashësve shqiptarë, shpesh herë gjendem në kontradikta të tipit: Si ishte dhe si është sot? Ishte më mirë atëherë apo është sot? Është një pyetje që shtrohet shpesh në tavolinat tona.

Normal se tani pas njëzet e tetë viteve demokraci punët duhet të jenë shumë më mirë; interneti ka ndryshuar çdo gjë: jetën, mënyrën e të nxënësve, metodat didaktike, mënyrën e të menduarit, kohëzgjatjen e orëve mësimore, raportin teorik e praktik. Ajo që dëgjova nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit (më pëlqeu jashtë mase) nxënësit në ciklin e ulët duhet ta zhvillojnë mësimin duke luajtur. Mendoj se kjo është një ide shumë demokratike dhe didaktike, të marrësh dije pa u ndjerë i lodhur e i mërzhitur, por duke u zbatuar. Kjo përveç aktiviteteve të ndryshme mund të realizohet edhe përmes platformës së E-Librit digjital, e cila tanimë ekziston dhe është në përdorim në Shqipëri. Që të realizohen të gjitha këto duhen njerëz të kualifikuar, profesionistë kreativë të dëshmuar në profesionin e vet, dhe, më kryesorja, të zhveshur nga politika, të cilët do të drejtonin apo realizonin projektin. Tani kjo reformë ka mundësitë maksimale që shqiptarët të favorizuar nga klima pozitive demokratike, të kenë në dorë fatin e fëmijëve tyre që përdorin tekstet shkollore në gjuhën shqipe. Dhe kjo reformë kërkon mësues modernë.

A i kemi? Besoj se po, por janë më komodë në punën që bëjnë si mësuesimdhënës, se sa të marrin përgjegjësinë e drejtimit, duke e ditur se nuk mund t'i shpëtojnë dot kthetrave të politikës. Meqenë-

se e njoh mirë këtë fushë nga përvoja gati njëzetë vjeçare në fushën e botimeve shkollore në të gjitha trevat shqiptare, mund të them me bindje dhe kurajë se për shqiptarët do të ishte momenti më i përshatshëm të krijonin tekste të përbashkëta në bazë të të njëjtave planprograme. Kjo do të mundësojë që të gjithë nxënësit të merrnin të njëjtat njohuri në lidhje me lëndët me karakter kombëtar, siç janë historia dhe gjuha e letërsia shqipe. Po kështu çmimi i teksteve detyrimisht do të ishte afërsisht tre herë më i lirë. Kjo është mëse e realizueshme dhe kërkon vetëm koordinim të punëve nga një grup profesionistësh nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Tekstet shkollore në përgjithësi hartohen mbi një program lëndor e kombëtar. Dhe tekstet që nuk plotësojnë këtë kërkesë bazike nuk mund të certifikohen dhe të përdoren në shkolla. Prandaj secili shtet në gjithë botën e qytetëruar i harton vetë tekstet për nxënësit e vet, përveç kombeve të prapambetura, të detyruar të përdorin përkthime nga tekste të shteteve të tjera.

Elementi kombëtar në programet shkollore është jashtëzakonisht i rëndësishëm në edukimin e gjeneratave të reja. Prandaj ai është dokumenti bazë, i cili në nivel kombëtar sjell vlerat dhe qëllimet e përgjithshme të edukimit dhe shkollimit (nxënies), përcakton pritshmërinë që nxënësit mundën dhe duhet të arrijnë, si dhe për çfarë mundën dhe duhet të jenë të përgatitur pas mbarimit të nivelit të caktuar të shkollimit, çfarë dhe si mundet dhe duhet mësuar, se si ndiqet dhe vlerësohet cilësia e arritjeve të nxënësve dhe puna e shkollave. Kurrikula lëndore është

plan-programi i lëndës mësimore në përputhshmëri me nivelin e moshës së nxënësit, me paradijen (nivelin paraprak të njohurive) dhe me ngarkesën e nxënësit në përputhshmëri me programin kombëtar. Pra, një libër që të plotësojë kriterin e parë thelbësor për t'u certifikuar si tekst shkollor, ai duhet të plotësojë kriterin numër një: kriterin e përcaktuar nga kurrikula lëndor e kombëtare. Kosova në drejtim të teksteve shkollore vazhdon me tekstet me programe të vjetra, duke deklaruar pothuaj çdo vit se do të hapë konkurse të reja, por në fakt kjo nuk ndodh. Deri sot vazhdohet me tekstet që nuk kanë ndryshuar për njëzet vjet, pra sado me vlerë të kenë qenë, tashmë iu ka ikur koha. Një numër i madh tekstesh fotokopjohen, duke humbur kështu edhe cilësinë e shtypit. Presheva, Bujanoci kryesisht furnizohet me libra nga Shqipëria dhe Kosova, kurse Mali zi përdor disa përkthime nga serbishtja dhe disa tekste nga Kosova.

Përkundër kësaj Shqipëria po bën një reformë të re në tekstet shkollore, duke ndryshuar që nga klasa e parë deri tek e mesmja; këtë vit janë në konkurrim klasa e katër dhe e nëntë, si dhe klasa e dymbëdhjetë. Risi në këtë reformë është numri i kufizuar i alternativave deri në tre libra për një lëndë, si dhe futja e lëndëve shkencore nga autorë të huaj. Në Maqedoni ka shumë vështirësi, sepse realizimi i pjesës kombëtare të programit u takon maqedonasve, prandaj problemet më të mëdha janë sidomos tek librat e historisë; po kështu tekstet në gjuhën shqipe zhvishen nga pjesa kombëtare e programit dhe nxënësit nuk mësojnë si duhet kulturën dhe historinë e kombit,

por atë të censuruarën nga shteti.

Normal që shtrohet pyetja: Pse përkthime nga gjuha maqedonase, kur fare mirë shqiptarët me dy-tre universitete në Tetovë e Shkup, me pedagogë, profesorë e doktorë shkencash nuk qenkan të aftë të shkruajnë librat për fëmijët e tyre? Deri tani, edhe kur shqiptarët merrnin guxim të konkurronin në konkurset e paraqitura nga Ministria e Arsimit, pengesa e parë ishte se nuk lejohej të konkurroje me dorëshkrime në gjuhën shqipe, por në gjuhën maqedonase. Dhe vetëm nëse fiton (që nuk ndodh ndonjëherë) librat përkthehen në gjuhën shqipe. Kjo është një padrejtësi shumë e madhe, që u bëhet mësuesve dhe në përgjithësi arsimimit në gjuhën shqipe. Tani që gjuha shqipe po zyrtarizohet, mendoj se autorët shqiptarë duhet të lejohen të përpilojnë tekste për nxënësit shqiptarë në gjuhën shqipe pa pasur nevojë të përkthehen nga gjuha maqedonase. Nga ana tjetër, mësuesit shqiptarë duhet të lejohen të përdorin tekste nga Shqipëria ose Kosova, sigurisht kur ato janë në përputhje me programin e miratuar nga Ministria e Arsimit e Maqedonisë. Nëse nxënësit serbë dhe ata boshnjakë në Kosovë përdorin tekste shkollore të botuara në Serbi e Bosnje, pse kjo mos lejohet për nxënësit shqiptarë në Maqedoni? Prandaj, përfitoj nga rasti të apeloj te të gjithë ata që duan arsimin dhe më të mirën për edukimin e fëmijëve të tyre, dhe që kanë mundësi të kontribuojnë në këtë drejtim, tani është koha për ndryshime dhe një herë e përgjithmonë të vendosen rregullat në fushën e teksteve shkollore dhe të programeve, veçanërisht për lëndët me rëndësi kombëtare.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 2 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup


NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shtojcë enigmatike e fundjavës

HORIZONTALISHT

- 3. Dajre
- 5. Aktori belg, Zhan Klod van
- 7. Ish basketbollisti amerikan, Skoti
- 9. Gjitar
- 10. Parafjalë, përqark
- 12. Bazë
- 13. Rifilloj
- 15. Vëzhgim, shqyrtim
- 16. Fyell
- 18. Banjë mjekuese
- 20. Aktorja kanadeze, Dyrans
- 23. Elefant
- 24. Prijësi i hunëve
- 26. Vendosje, themelim
- 28. Djalë i djalit
- 29. Qytet në Jordan
- 30. Përemër vetor
- 31. Ngadalë
- 33. Ndërkombëtar
- 41. Emri i këngëtares sonë në foto**
- 42. Mbiemri i këngëtares në foto**
- 43. Ujdhesë në Kroaci
- 44. Tumori i indeve të muskujve
- 47. I moshës së re
- 48. Ushtarak me gradë
- 49. Grup i përbërë nga tre njerëz apo sende

FJALËKRYQI KLASIK



VERTIKALISHT

- 1. Ndajfolje, më shumë se ç'duhet
- 2. Takohem me dikë rastësisht
- 3. Grupi anglez, Përpëll
- 4. Xhehenemi
- 5. Çitjane
- 6. Pjesa kryesore e një limani
- 8. Pjesë e ligjit
- 9. Pjesë e lojës së tenisit
- 11. Çakia, biçaku
- 12. Studim më i hollësishëm
- 14. Ndajfolje sasie
- 15. E ndaluar me fe
- 17. Dukuria valore
- 18. Shosha
- 19. I moshuar
- 21. Filozofi gjerman, Imanuel
- 22. Mahia e çatisë
- 23. Religjion
- 24. Këngëtari ynë, Skenderaj
- 25. Inicialet e shkrimtarit Prokshi
- 27. Festat fetare
- 30. Haptas
- 32. Aktiniumi
- 33. Revistë arbëreshe e de Radës, "... i Arbëreshvet"
- 34. Detektivi amerikan, Eliot
- 35. Ish futbollisti anglez, Ualsh
- 36. Aktorja amerikane, Margaret
- 37. Erstedi
- 38. Numri (shkurt.)
- 39. Lingua Tertii Imperii
- 45. International Public Relations Association
- 46. Vitet e mbushur të jetës.

Kakuro

e lehtë

			17	30	
		17			
		29			17
	30				
	3				
7			16		
			3		
20					
	9				

mesatare

		29	3		
	9				
				11	16
	17				
	4				
12			11		
			17		
21					
		10			


e vështirë

		35	3	15	
	12				
	16				
19					17
15			9		
			17		
	26				
	22				





FSHEHËSIRA

Gjej figurat që fshihen në fotografi. Ku?




DALLIMET

Gjej dallimet në fotografitë e mëposhtme!




ZBULIMI

Ngjyrosni numrat me ngjyra të ndryshme që të zbuloni figurën!




VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!



LABIRINTI

Cili nga tre piratë e ka rrugën e drejtë deri te harta?



KAM NEVOJË PËR GRUAN...

Që kur mori arratinë, Ghassani pret përditë lajmin e lejimit të gruas që të vijë tek ai në Gjermani. Më shumë se 30 muaj kanë kaluar që kur çifti jeton i ndarë. Është në dorën e politikanëve gjermanë që kjo të ndryshojë

Dhoma 206 në strehimin e përbashkët të Caritasit "Te çobani i mirë" në Berlin është aktualisht bota e Ghassanit. Një tavolinë, një karrige, dy krevate në më pak se 20 metra katrorë: këtu siriani 37 vjeçar pret së bashku me një refugjat tjetër si do të vendoset për të ardhmen e tij. "Gjermania është për mua një shans për fillim të ri", thotë burri me vetulla të zeza dhe me buzëqeshje të ndrojtur. Në korrik 2015 ai u arratis, si shumë të tjerë përmes itinerarit ballkanik. Qyteti i tij, Abu Kamal ishte ndër të parët ku Assadi shtypi me dhunë në vitin 2011 demonstratat. Më vonë aty erdhi Shteti Islamik, deri sa Assadi e rimori territorin në nëntor 2017. Gruaja 34 vjeçare e Ghassanit vazhdon të jetojë në një kamp refugjatësh në Liban. Më pak se nëntë vjet kishte kaluar që kur qenë martuar, kur të dy u arratisën në vitin 2013 në vendin fqinj. Dy vjet i kaluan atje në kampe, dhe në vitin 2015 Ghassani u nis për në Evropë, i vendosur që të tërheqë më vonë edhe gruan. Komunikimi



me WhatsApp që kur janë ndarë, 30 muaj më parë, teknikisht funksionon, por emocionalisht situata bëhet gjithnjë e më e vështirë, që kur është bërë e qartë që gruaja e tij ka ngecur në Liban, kurse ai në Gjermani. "Kam nevojë për gruan time për këtë fillim të ri", thotë Ghassani. Përpara se të merrte arratinë, Ghassani punonte si mekanik te një tregtar makinash. E shoqja që infermiere, deri sa e ndërpreu punën, për t'u kujdesur për të ëmën të sëmurë rëndë. Ai thotë se e shoqja jeton krejt e izoluar në kamp. Nga frika ai nuk e publikon emrin e saj. Dëshira më e madhe e Ghassanit është që e shoqja të ketë mundësi të vijë. Fëmijë

çifti nuk ka. Lutja e tij ndodhet në Zyrën Federale për Migrimin dhe Refugjatët në Nürnberg. Që prej vitit 2016 bashkimi familjar për këtë grup refugjatësh me qëndrim të kufizuar është ndërprerë krejtësisht, nga frika e politikanëve se mund të pasonin valë të mëdha të tjera migrimi. Këtë të martë, partitë unioniste, CDU-CSU dhe SPD ranë dakord që të miratojnë lejimin e një kontingjenti të caktuar për bashkim familjar dhe për rregulla për raste të vështira. Mbi krevatin e Ghassanit, në mur rri varur një tabelë e vjetër shkolle. "Megjithëse jeta është e vështirë. Jetoje", shkruhet në të me shkumës të bardhë dhe me një shkrim të pa-



"Kam nevojë për gruan time për këtë fillim të ri", thotë Ghassani. Përpara se të merrte arratinë, Ghassani punonte si mekanik te një tregtar makinash. E shoqja që infermiere, deri sa e ndërpreu punën, për t'u kujdesur për të ëmën të sëmurë rëndë. Ai thotë se e shoqja jeton krejt e izoluar në kamp

sigurt nxënësi. Së fundi, pasiguria për fatin e së shoqes dhe ndjenjat e fajit e lënë pa gjumë. Gjithnjë e më shumë për të fjetur ai merr medikamente, na tregon. Megjithë

Mbi krevatin e Ghassanit, në mur rri varur një tabelë e vjetër shkolle. "Megjithëse jeta është e vështirë. Jetoje", shkruhet në të me shkumës të bardhë dhe me një shkrim të pasigurt nxënësi



mirënjohjen për pranimin e tij, politikanët gjermanë ai i akuzon se harrojnë një gjë: "Ata nuk e kuptojnë sa e vështirë është që të jetojsh pa familje".

Kthesë në Oksford, tani vajzat janë më shumë se djemtë!

Pas 8 shekujsh! Deri në vitet '70, dominimi mashkullor ishte total. Kjo është zbuluar nga të dhënat e azhornuara vitin e kaluar nga UCAS, një organ që merret me procedurat për qasje në universitetet e Mbretërisë së Bashkuar



U deshën 800 vjet histori, një mijë duke marrë në konsideratë rrënjët e pararendësve, por në fund gratë e bënë atë: në vitin 2017 ata i kapërcyen burrat sipas numrit të hyrjeve në sallat e Universitetit prestigjioz të Oksfordit, shenjtërores së kulturës Akademike angleze dhe evropiane.

Kjo është zbuluar nga të dhënat e azhornuara vitin e kaluar nga UCAS, një organ që merret me procedurat për qasje në universitetet

e Mbretërisë së Bashkuar. Një pikë kthese historike, pas një marshi shumë të gjatë: edhe nëse gjithçka duhet të konsolidohet, sipas asaj që pranojnë të njëjtat burime të institucionit. Numrat në çdo mënyrë shënojnë një kthesë, që vërteton, si në 2017-ën universiteti i ka ofruar mundësinë për të konkurruar për regjistrim 1.275 vajzave ndaj djemve 1165. Dhe në testet përfundimtare, në vjeshtë, ai

pranoi 1.070 gra dhe 1.025 burra. Një parakalim i papritur, duke parë se "konkurenti" Cambridge, shtylla tjetër e elitës së Akademisë britanike, nuk mund të mburret, pavarësisht zvogëlimit të hendekut gjinor në terma minimalë, sipas vlerësimeve të zhvilluara nga UCAS për të njëjtën periudhë. "The Times" thekson se ka kaluar shumë shekuj që Oxford - i themeluar zyrtarisht në 1231 mbi themelet e një

studimi të hershëm mesjetar që datojnë që 1096 - u përruar nga Lady Margaret Hall: "këndi" e tij i parë i rezervuar për gratë, në kohën e atëhershme, ishte i autorizuar për të ndjekur disa kurse dhe jo për t'u diplomuar. Për të arritur te titujt studimorë për femrat në vitin 1920, pa llogaritur që auditorët mbetën të hapura për studentët meshkuj deri në fillim të viteve 1970.

Por në vitin 1974, u hap drita e gjelbër për gratë e kolegjit të parë 'oxfordian'. Asgjë nuk ka të bëjë me realitetin e sotëm, të shënuar nga një rritje e pranisë së femrave në kuadër të Fakultetit dhe kërret e fakulteteve me gratë në krye. Të dhëna, që në anën tjetër nuk e bëjnë euforinë të thërrasë. "Janë pozitive, por është shumë shpejt për t'i interpretuar ato si një trend, duke pasur parasysh se në rastin e mbishkrimeve të reja ata i referohen një viti të vetëm" komentoi me kujdes një nga zëdhënësist universitar cituar nga "The Guardian". Ndërsa profesor Les Ebdon, drejtor i Zyrës për barazi në qasje në arsimin e lartë në Angli, vuri në dukje se episodi 'parakalimi' i Oksfordit nuk është i mjaftueshëm për të shëruar trashëgiminë e së kaluarës në një vend që përshkohet ende nga pabarazi të thella.

Pabarazi, që kanë arsye të shumta dhe komplekse, sipas Ebdon, i bindur se "ndryshimi" i ritmit nuk mjafton të japë shpresë për të gjithë ata që vazhdojnë të "lihen jashtë" padrejtësisht. Nga gardhi i privilegjuar i 'Oxbridge' dhe më gjerë...



Ky është kushti që Serbia të hyjë në BE

Komisari evropian për Zgjerim e Politikë Fqinjësore, Johannes Hahn, në një intervistë për gazetën vjeneze "Kurir", ka thënë se viti 2025 është data e përafërt për pranimin e vendeve të reja anëtare në Bashkimin Evropian. Siç përcjell agjencia serbe e lajmeve tanjug, Serbia mund të anëtarësohet vetëm nëse i zbaton shpejt dhe vendosmërisht hapat reformues dhe nëse marrëdhëniet me Kosovën i normalizon në mënyrë të detyrueshme e të përhershme. Hahn ka përmendur edhe kushtet tjera, ekonomike e politike për që duhet t'i përmbushë Serbia.



Kërcënohet me jetë Nikos Kotzias

Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias është kërcënuar me vdekje. Ai ka marrë një letër anonime në të cilën shkruhet "Kemi tre plumba për ju". Lajmi është konfirmuar nga ministri i mbrojtjes së qytetarëve Nikos Toskas. Sipas tij, dikujt nuk i përbejnë mënyrat e negociatave mes Athinës dhe Shkupit, për zgjidhjen e çështjes së emrit të Maqedonisë. Në një deklaratë për mediat Toskas tha se kërcënimin nuk është vetëm për Kotzias, por edhe për familjen e tij. "Zoti Kotzias po përpiqet ta zgjidhë çështjen e emrit të Maqedonisë me taktika mjeshtrërore, nën urdhrat e kryeministrit" u shpreh ministri grek, duke theksuar se qëllimi i letres është nxitja e terrorit. Ministri i Jashtëm grek Kotzias, me anë të një postimi në Twitter, i bëri thirrje Partisë Demokratike e Re dhe Sinodit të Shenjtë, të denonjë me çdo kusht kërcënuesit. Autoritetet greke po hetojnë për të zbardhur autorët e kërcënimit të shefit të diplomacisë. Kërcënimin vjen vetëm pasi takimeve që ndërmjetësi I OKB-së, Methju Nimi zhvilloi me zyrtarë të lartë të Maqedonisë e Greqisë.

Kemi një vijë të kuqe me Greqinë

"Marrëveshja e re për detin me Greqinë do të jetë për Shqipërinë shumë më e mirë se ajo antikush-tetuese e vitit 2009 dhe do të jetë e bazuar katërcipërisht në kornizën e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë". Kështu deklaroi të enjten në mbledhje në ERTV, transmeton ATSH, kryeministri Edi Rama, për negociatat me Greqinë, duke u

ndalur të marrëveshja për kufirin detar. I pyetur mbi mungesën e transparencës lidhur me negociatat për çështjen e kufirit detar, kryeministri Rama theksoi se "ne nuk kemi arsye të shpjegojmë asgjë, për sa kohë jemi në një tryezë negociimi dhe derisa të shkruhet e zeza në të bardhë ajo që ne po negociojmë". "Jemi në një proces ku po finalizojmë një

përpjekje mbi 3 vjet e gjysëm, me një konflikt të krijuar në funksion të vendosjes së barazisë në marrëdhënie me fqinjin. Ne jemi në diskutime.

Ajo që po ju them është që ne kemi një vijë të kuqe që e kemi vendosur që në fillim. Sot vija e kuqe është në tavolinë dhe marrëveshja e re do të jetë më e mirë dhe e bazuar në parimin e barazalargë-




sisë që garantohet nga konventa me 12 miljet, por e axhustuar", tha Rama.

KOSOVA TË MOS U OFROJË ARSYE SHTETEVE PËR MOSNJOHJE

"Kur vie puna tek shtetësia, çdo vend përballlet me vështirësi të mëdha, dhe nuk shoh arsye pse Kosova të përjashtohet nga ky rregull", thotë Schwarzenberg në një bisedë me Radion Evropa e Lirë të zhvilluar në Pragë

Karel Schwarzenberg, një nga figurat kyçe në politikën çeke në disa dekadat e fundit, më ndërprente qysh në fillim të bisedës tonë për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. "Ka kaluar shumë kohë", thotë duke qeshur, teksa bëhet gati të japë mendimin e tij rreth rrugëtimit të një shteti, të cilin kur shërbente si ministër i Jashtëm i Çekisë në vitin 2008, kishte vendosur ta njohë, megjithë kundërshtitë e fuqishme nga një pjesë e skenës politike në vendin e tij. Dhjetë vjet më pas, tani ai thotë se Kosova po shënon "zhvil-



lime pozitive", porse "ka ende shumë punë për t'u bërë" që Kosova të pranohet si vend i respektuar në politikën ndërkombëtare. Përveç luftimit të korrupsionit dhe ndërtimit të infrastrukturës - universiteteve dhe shkollave, siç i përmend ai ish-diplomati, që aktualisht është deputet në Parlamentin e Çekisë, thotë se të gjithë shtetet duhet që të përballen me të kaluarën e tyre. "Kur vie puna tek shtetësia, çdo vend përballlet me vështirësi të

mëdha, dhe nuk shoh arsye pse Kosova të përjashtohet nga ky rregull", thotë ai në një bisedë me Radion Evropa e Lirë të zhvilluar në Pragë. Në vitin 2008, vetëm dy ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ish-ministri Schwarzenberg kishte treguar vullnetin për ta njohur pavarësinë e saj. "Ne do të shohim se sa vende evropiane do ta njohin Kosovën, dhe se si do të silllet Qeveria e Kosovës. Ne do ta marrim vendimin bazuar në këto fakte. Për këtë

arsye nuk do të përmend ndonjë datë në veçanti - ne do të punojmë me fakte, dhe jo data", kishte thënë ai më 19 shkurt të vitit 2008. Vendimi i tij ishte kundërshtuar nga disa parti politike, përfshirë edhe ish-presidentin Vaclav Klaus. Në fakt, edhe presidenti aktual i Çekisë, Miloš Zeman, që u rizgjodh në këtë pozitë para pak javësh, e që konsiderohet si më i afërt me Rusinë, nuk njihet si mbështetës i pavarësisë së Kosovës.

Vrasja e Ivanoviqit përplas Prishtinën dhe Beogradin

"Prishtina nuk i ka ofruar informacione Serbisë lidhur me atë se deri ku ka arritur hetimi për vrasjen e Oliver Ivanoviqit", deklaroi dje Marko Gjuriq, duke thënë se institucionet ndërkombëtare duhet të reagojnë që ta "shtyjnë" Prishtinën për të bashkëpunuar me Beogradin.

Nga Serbia thonë se nuk kanë marrë asnjë përgjigje cilësore dhe relevante për këtë vrasje, duke deklaruar se ajo ndodhi në territorin nën juridiksionin e tyre dhe se Serbia do të vazhdojë hetimet e saj. Mirëpo, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka dekla-



ruar se kjo çështje tashmë është duke u hetuar nga Prokuroria Themelore e Mitrovicës, duke bërë të ditur se një prokuror shqiptar dhe një serb po kryejnë hetimet. Ai ka

shtuar se tashmë janë mbledhur disa prova, por jo edhe identiteti i vrasësit. Sa i përlet akuzave nga Serbia për mosbashkëpunim, Lumezi u përgjigjet duke thënë se si-

pas Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, fillimisht ata duhet t'i dorëzojnë informacionet që kanë lidhur me këtë rast, ndonëse Serbia nuk kanë marrë asnjë informacion deri më tani, saktësoi Lumezi. Sipas tij, ky rast është duke u hetuar nga Prokuroria Themelore e Mitrovicës, dhe me të po merren një prokuror shqiptar dhe një serb.

"Ne i kemi disa prova, të cilat i kemi siguruar deri tani, mirëpo nevojitet që ende të marrim veprime për zbulimin e identitetit të kryesit të veprës penale", tha Lumezi në një intervistë për Arbresh.info.

IZRAELI DO TË VENDOSË TAKSA PËR KISHAT DHE PRONAT E OKB-së

Komuna e Kudsit do të fitojë dhjetëra miliona dollarë nga taksat mbi pothuajse 900 pronave të kishave dhe OKB-së në qytet

Izraeli ka filluar të imponojë taksat për pronat e kishave dhe OKB-së në Jerusalemin Lindor të okupuar. E përditshme në gjuhën hebraike "Israel Hayom", njoftoi se Komuna e Jerusalemit do të fitojë dhjetëra miliona dollarë nga taksat mbi pothuajse 900 pronave të kishave dhe OKB-së në qytet. "Komuna ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe zyrën e kryeministrit se nga tani e tutje do të kërkojë që kishat dhe institucionet e lidhura me OKB-në (në Jerusalemin Lindor) të paguajnë tatime mbi pronat e tyre përkatëse", thuhet në raportimin e gazetës. Më herët këtë



javë, autoritetet komunale të Jerusalemit vendosën kufizime mbi llogaritë lokale të kishave armene, romake dhe ungjillore, duke i thirrur në gjyq për mospagesën e tyre të taksës së pronave.

Vendimi i presidentit të SHBA-ve, Donald Trump, për të njohur Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit duket se e ka inkurajuar Izraelin

që të miratojë hapa të reja që synojnë forcimin pushtimin të saj në qytet. Muajin e kaluar, Parlamenti i Izraelit (Knesset) miratoi legjislacionin që e bën më të vështirë ndryshimin zyrtar të Jerusalemit ose ndryshimin e kufijve komunalë. Më 6 dhjetor të vitit të kaluar, presidenti i SHBA-ve zyrtarisht e njohu Jerusalemin si kryeqytet të

Izraelit, duke shkaktuar një kundërshtim të gjerë dhe protesta nga e gjithë bota arabe dhe muslimane. Jerusalemi mbetet në zemër të konfliktit të Lindjes së Mesme, me palestinezët duke shprehur që Jerusalemi Lindor, i pushtuar nga Izraeli që nga viti 1967, përfundimisht të shërbejë si kryeqytet i një shteti palestinez.



Tensionohen marrëdhëniet Turqi-Greqi

Ministria e Jashtme greke, nëpërmjet zëdhënësit të saj Aleksandros Gjenimatas, i është përgjigjur ashpër deklaratave një këshilltari të presidentit të Turqisë, Rexhep Tayip Erdogan, me anë të të cilave ai ka kërcënuar kryeministrin grek Aleksis Tsipras dhe Ministrin e Mbrojtjes Panos Kamenos. Duke marrë si shkas vizitën e këtij të fundit në ujërat pranë ishullit Imia, për të hedhur një kurorë me lule në kujtim të tre oficerëve grekë që humbën jetën gjatë incidentit më të nxehtë midis dy fqinjëve në Egje, 22 vjet më parë, Jigit Bulut, gjatë një programi televiziv, ka thënë: "Athina do të ndiejë zemërimin e Turqisë, më keq se në Afrin. Ne do të thyejmë këmbët dhe duart e zyrtarëve, kryeministrit apo çdo ministri që do guxojë të shkelë në Imia, në Egje", tha këshilltari i Erdogan. Athina zyrtare i ka cilësuar deklaratat e tij, të padenja, të huaja për kulturën politike evropiane dhe i ka bërë thirrje këshilltarit të presidentit turk, që duke pasur parasysh postin, të kuptojë se qëndrime të tilla nuk ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Gjithashtu, Ministria e Jashtme greke ka theksuar se statusi ligjor i Egjeut është i qartë dhe i garantuar me ligj ndërkombëtar. Tensionet mes Athinës dhe Ankarasë janë shtuar ditët e fundit, pas përpjekjes së flotës turke të pengojë dy luftanijet greke, në të cilat ndodhën ministri i Mbrojtjes, Kamenos, të lundrojnë pranë ishullit Imia. Athina ka përgënjeshtuar publikimet e mediave turke, sipas të cilave Kamenos nuk mundi të shkojë në vendngjarje, duke publikuar videot përkatëse nga memoriali i hedhjes së kurorës pranë ishullit të kontestuar nga Ankaraja.

Vetëvritet i biri i Fidel Kastros



Djali më i madh i udhëheqësit revolucionar kuban, Fidel Castro, Fidel Castro Diaz-Balart, është vetëvrasë në moshën 68-vjeçare, pas rënies në një gjendje depresive, raportojnë mediat shtetërore kubane. Castro Diaz-Balart, i njohur edhe si "Fidelito" për shkak të përngjasimit me të atin e tij, fillimisht ishte shtruar në spital për depresion dhe më pas vazhdoi trajtimin ambulator. Fidelito ka lindur në vitin 1949 nga martesja e babait të tij me Mirta Diaz-Balart para se ai të rrëzonte një diktator të mbështetur nga SHBA dhe të ndërtonte një shtet të drejtuar nga komunistët gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Një fizikant bërthamor që studioi në ish-Bashkimin Sovjetik, Castro Diaz-Balart kishte punuar si këshilltar shkencor në Këshillin Kuban të Shtetit dhe nënkryetar i Akademisë Kubane të Shkencave. Më parë, nga viti 1980 deri në 1992, ai ishte kreu i programit kombëtar bërthamor të Kubës dhe drejtoi zhvillimin e një centrali bërthamor në ishullin më të madh të Karaibeve. Vdekja e tij erdhi një vit pas asaj të babait të tij më 26 nëntor 2016, i cili vdiq në moshën 90-vjeçare.

Apo përgatitet intervenimi amerikan në Siri?

Administrata e presidentit amerikan Donald Trump është e gatshme që të veprojë përsëri ushtarakisht kundër qeverisë siriane, nëse është e nevojshme, për shkak të përdorimit të armëve kimike për të cilat frikohet se po i zhvillon Damasku, kanë zbuluar të enjten zyrtarët e lartë amerikan. Forcat besnike ndaj kryetarit sirian Bashar al-Asad po vazhdojnë kohë pas kohe me përdorimin e armëve kimike në sasira të vogla, prej sulmit vdekjeprurës në prill të vitit të kaluar i cili ka shkaktuar sulmin amerikan me raketa në aeroportin ushtarak, kanë thënë zyrtarët. Karakteristikat e sulmeve të fundit tregojnë se Siria po e zhvillon armën e re dhe metodat e përdorimit. Nëse komuniteti ndërkombëtar nuk vepron shpejt për të krijuar presion në



Asad-in, arma kimike siriane mund të shpërndahet jashtë shtetit e ndoshta madje edhe në SHBA, pretendon njëri prej zyrtarëve të cilët kanë dashur të mbesin anonim. Besohet se qeveria e Asad-it i mban rezervat e armëve kimike përkundër marrëveshjes amerikano-ruse sipas të cilës Damasku ishte dashur t'i dorëzojë në vitin 2014 për

shkatërrim, theksojnë zyrtarët. Ata e kanë përsëritur akuzën e sekretarit të shtetit Rex Tillerson i cili ka thënë se Rusia, aleati i Asad-it në konfliktin sirian, pjesërisht është përgjegjëse për mungesën të implementimit të ndalesës së armëve kimike. Rusia këtë e ka hedhur poshtë, ndërsa qeveria siriane pretendon se nuk i ka kryer ato sulme.

Përmbysset varka me mbi 90 emigrantë

Të paktën 90 emigrantë mendohet se janë mbytur pasi një varkë është përmbysur në bregun e Libisë, thotë agjencia e migracionit e OKB-së. Tre të mbijetuar thanë se shumica e emigrantëve që u mbytën ishin shtetas pakistanezë. Olivia Headon, një zëdhënëse e IOM, tha se 10 kufoma kishin gjetur në breg, pranë qytetit libian të Zuwara. Tetë besohet të ishin pakistanezë dhe dy libanë. Nuk

dihen ende shkaqet e ngjarjes dhe numri i saktë i viktimave. Libia ka qenë për vite me radhë një rrugë kryesore tranziti për emigrantët që përpiqen të arrijnë në Evropën Jugore nga deti. Por vitin e kaluar BE arriti një marrëveshje të diskutueshme për të ofruar ndihmë për rojet bregdetare libiane për të ndaluar rrjedhën e anijeve që mbanin emigrantë dhe refugjatë në Itali.



Filmi "Lulet plastike" në Festival International du Film d'Aubagne

Filmi me metrazh të shkurtër "Lulet plastike" me autor dhe regji të Ylljet Aliçka është zyrtarisht në Festival International du Film d'Aubagne në Francë. Festivali i filmit do të zhvillohet nga datat 19 mars deri më 24 mars të këtij viti. Festival International du Film d'Aubagne është e fokusuar në promovimin e krijimit të ri kinematografik dhe përbërjes muzikore në film. Ky festival synon që të favorizojnë shfaqjen e talenteve të reja ndërkombëtare dhe ky festival do të jetë një vend trajnimi dhe krijimi për autorët e rinj si drejtorët, skenaristët dhe kompozitorët. Thesimi i diversitetit kulturor është aksioma e Film d'Aubagne. Gjithashtu ofron një platformë për artistët nga imazhi dhe zëri, një vend sensibilizimi dhe trajnimi, duke mundësuar bashkëpunim të përfunduar. Nuk është hera e parë që filmi "Lulet plastike" udhëton jashtë kufijve shqiptarë për të shfaqur premirën në festivale filmi. Prej datës 2 deri në 7 maj të vitit që kaloi u Festivali i Filmit të Pavarur në New York. Shqipëria u përfaqësua me dy prodhime të saj, me filmin me metrazh të shkurtër "Lulet plastike" si dhe dokumentarin "Dritë". Festivali njihet për etjen e tij për të përqaftuar ide të reja si dhe të zbulojë talente, duke i ofruar atyre një treg të rëndësishëm, por dhe publik me sqimë si ai njujorkez. "Lulet plastike" është shfaqur gjithashtu edhe në Eastern Neighbours Film Festival" në Hollandë. Filmi "Lulet plastike" që mban emrin e Ylljet Aliçkës si autor e regjisor tregon historinë e jetës nën vetmi të një çifti të moshuar nga fshati që vijonë në Tiranë me entuziazëm në një dasmë ku janë të ftuar, dhe nga kënaqësia e madhe që do të jenë në këtë dasmë dhe do të shoqërojnë krushqit përballen me vetminë e të qenurit në një komunitet ndryshe. Por nga ky mënjanim, krahas kësaj ndjesie vetmie fillon dhe rizbulimi i njëri-tjetrit. Filmi është bazuar në tregimin "Çifti" shkruar nga Aliçka. Filmi përcjell mesazhe, që nuk është kurrë vonë dhe nuk ka asnjë vend në historinë njerëzore që nuk mund ta rigjejnë ngrohtësinë shpirtërore dy njerëz, qofshin të moshuar, nga fshati apo qyteti. Ky film ka rikthyer në ekran aktorin e njohur Robert Ndrenika si dhe aktorët Zana Pifti, Gent Hazizi apo Elia Zaharia. Kjo është hera e dytë që Aliçka bashkëpunon me aktorin Robert Ndrenika pas filmit "Parrullat", apo "Kronikë provinciale" Xhirimet janë realizuar në Tiranë dhe Shën Gjergj. Në këtë të fundit, prania e Robert Ndrenikës përbëri një ngjarje të pazakontë për fshatin.



Viti 2017 duket se ka shënuar një "zgjim" kulturor për shqiptarët në lidhje me frekuentimin e shfaqjeve në teatër, ekspozitave në galeri apo vizitave në muze. Shifrat kanë një rritje domethënëse në raport me vitin 2016. Instituti i Statistikave publikoi statistikën kulturore ku bie në sy një rritje dyshifrore për të gjithë grupet me përjashtim të atyre që shkojnë në bibliotekë.

SHFAQJET, RITJE 52.6%

"Numri i shfaqjeve kulturore në tremujorin e katërt 2017 është 335, i barabartë me numrin e shfaqjeve në tremujorin e katërt 2016. Në vitin 2017, numri i shfaqjeve/ekspozitave është 831, duke pësuar një rënie me 13,5 % në krahasim me 2016. Në tremujorin e katërt 2017 numri i spektatorëve është rreth 102 mijë, duke pësuar rritje me 69,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i spektatorëve në vitin 2017 është 173.594, me një rritje prej 52,6 % krahasuar me 2016" thuhet në shifrat e INSTAT.

Injenti raport nënvizon se pjesëmarrja mesatare në tremujorin e katërt 2017 është 304 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka

pësuar rritje me 69,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Për vitin 2017, pjesëmarrja mesatare ka pësuar një rritje me 76,5 % krahasuar me vitin e mëparshëm.

"Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, 132 shfaqje/ekspozita në tremujorin e katërt 2017. Numri i spektatorëve në tremujorin e katërt 2017, është 17.389, duke shënuar rritje 33,3 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Numri mesatar i spektatorëve gjatë tremujorit të katërt 2017 është 132 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rritje prej 32,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm"

Rritje të numrit të shfaqjeve kulturore ka pasur edhe nga Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor në tremujorin e katërt 2017. Në total janë regjistruar është 61 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rritje me 45,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Në tremujorin e katërt 2017, numri i spektatorëve është 28.000 duke shënuar rritje me 162,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Numri mesatar i spekta-

torëve në tremujorin e katërt 2017 është 459 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rritje me 80,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Numri i shfaqjeve të realizuara nga Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor në 2017 është 99 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rënie me 24,4 %, krahasuar me vitin 2016. Për vitin 2017 numri i spektatorëve/vizitorë është 49.284 me një rritje 177,3 % krahasuar me 2016.

VIZITAT NË MUZE

"Numri i vizitorëve në muze në tremujorin e katërt 2017 është 52.805, duke shënuar rritje me 60,9 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 18,9 %, ndërmjet tremujorit të katërt 2017 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2016. Në tremujorin e katërt 2017 numri i vizitorëve në parqe arkeologjike është 29.650, me një rritje prej 42,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Numri i vizitorëve në muze, kala e monumente të tjera dhe në parqe arkeologjike për vitin 2017 është

669.110, duke shënuar rritje me 21,7 %, krahasuar me 2016" vlerëson INSTAT.

BIE INTERESI PËR LIBRIN?

Bibliotekat kanë pësuar rënie të frekuentuesve edhe pse kjo nuk tregon në mënyrë të plotë nëse ka rënë interesi për leximin pasi qytetarët mund ta bëjnë këtë edhe përmes blerjes së titujve në mënyrë private. Referuar INSTAT numri i shërbimeve të njëjësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibliotekës Kombëtare në tremujorin e katërt 2017 është përgjysmuar krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Ky numër për vitin 2017 ka pësuar një rënie respektivisht me 53,0 % për shërbimin e njëjësive dhe 41,3 % për numrin e frekuentuesve, krahasuar me një vit përpara.

"Në tremujorin e katërt 2017, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 5.464 botime, 18,1 % më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 1.046 ishin tituj të rinj dhe 4.418 ekzemplarë të rinj. Numri i botimeve për vitin 2017 është 11.642, duke u rritur me 8,1 %, krahasuar" thuhet në raportin e INSTAT

Kur monarkia Austro-Hungareze kërkonte unifikimin e gjuhës shqipe

Vija konstante që përshkon qëndrimin austro-hungarez edhe për sa i përket gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj është synimi për të bashkuar shqiptarët, përfshirja e të gjithë faktorëve relevantë për çështjen kombëtare pa dallime fetare a krahinore

Në fushën e interesit të Austro-Hungarisë për formimin e kombit shqiptar në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, një nga aspektet më të rëndësishme ishte çështja e një gjuhe të përbashkët shqipe për gjithë shqiptarët, si mjeti kryesor për bashkimin kombëtar në rrethanat e nevojës politike të Austro-Hungarisë për nxitjen e ndjenjës kombëtare të shqiptarët. Ky program politik i Monarkisë austro-hungareze kishte

për qëllim të krijonte një Shqipëri të bashkuar si kundërpeshë ndaj Serbisë dhe frenim të pansllavizmit që përkrahej nga Rusia, bën të ditur Gazeta Shqiptare.

Nga dokumentacioni shumë i pasur burimor arkivor del i qartë roli nxitës i Monarkisë së dyfishtë nëpërmjet diplomatëve të saj për një gjuhë të përbashkët shqipe dhe një alfabet të njëjësuar të shkrimit të saj. Omari tha se ndër emrat më të spikatur, që ushtruan ndikim veçanërisht në çështjen e gjuhës shqipe, ishin Theodor Ippen dhe August Krali, njohës të mirë të gjuhës, zakoneve dhe karakterit të shqiptarëve, që arritën të sheshojnë mosmarrëveshjet dhe të ulin palët në bisedime për arritje kompromisi. Sipas saj, vija konstante që përshkon qëndri-

min austro-hungarez edhe për sa i përket gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj është synimi për të bashkuar shqiptarët, përfshirja e të gjithë faktorëve relevantë për çështjen kombëtare pa dallime fetare a krahinore, vështrimi kombëtarist i çdo përpjekjeje për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Prof.Dr.Omari tha se i njëjti qëndrim vihet re edhe në përpjekjet për një gjuhë të njëjësuar letrare shqipe, tashmë në rrethanat e ndryshme të pushtimit austro-hungarez të Shqipërisë në vitet 1916-1918. Në Komisinë Letrare të krijuar me nismën e August Kralit dhe me vullnetin e patriotëve shqiptarë në 1916 u konfirmua vendimi i Kongresit të Elbasanit për dialektin e këtij qy-

teti si bazë e gjuhës e përbashkët letrare e të gjithë shqiptarëve. Ky ishte i pari dekret për shqipen si gjuhë zyrtare dhe drejtshkrimin e saj. Nga dokumentet e botuara del në pah edhe në këtë çështje roli vendimtar i përfaqësuesit austro-hungarez për bashkimin e shqiptarëve.

Studimi i prof.dr.Omarit, sipas Gazeta Shqiptare, u bë publik më 27 janar kur ajo mori pjesë në konferencën shkencore me temë: "Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918", të organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Ambasadën Austriake. Ajo referoi kumtesën me temë: "Çështja e gjuhës së përbashkët shqipe dhe ndikimi i diplomacisë austro-hungareze në të"

"Qëllimi i vizitës tonë lidhej me shqetësimin, pas sinjalizimeve që kemi marrë së fundmi rreth tentativave të palëve të treta për të ndërhyrë në procesin zgjedhor. Synimi ynë është një dhe i vetëm: të nënvijëzohet se duhen respektuar principet e UEFA-s, principi i demokracisë, i transparencës dhe i zgjedhjeve të lira", pohon Surkis

NUMRI DY I UEFA-SË GRIGORIY SURKIS QËNDROI NË SHQIPËRI

DUAM PROCES TË LIRË



Garantimi i zgjedhjeve demokratike dhe mbi të gjitha pa ndërhyrje politike në Federatën e Futbollit të Shqipërisë, solli në Shqipëri një prej eksponentëve më të lartë të UEFA-s. Rreth mbarëvajtjes së procesit të 7 shkurtit, zv.presidenti i Konfederatës Evropiane, Grigoriy Surkis u takua me kryeministrin Edi Rama, ndërsa më pas zhvilloi një bisedë me presidentin e FSHF-së, Armand Duka. "Delegacioni ynë erdhi në Shqipëri me një mision paqeje, sipas

udhëzimeve që kemi marrë nga presidenti i UEFA-s, Çeferin. U takuam me kryeministrin: ishte një ndeshje që zgjati 90 minuta, por nuk kaloi shtesë apo penallti. E dëgjuaam njëri-tjetrin dhe kuptuam pozicionet e secilës palë. Qëllimi i vizitës tonë lidhej me shqetësimin, pas sinjalizimeve që kemi marrë së fundmi rreth tentativave të palëve të treta për të ndërhyrë në procesin zgjedhor. Synimi ynë është një dhe i vetëm: të nënvijëzohet se duhen respektuar princi-

pet e UEFA-s, principi i demokracisë, i transparencës dhe i zgjedhjeve të lira. Principe të cilat nuk lejojnë ndërhyrjen e palëve të treta në procesin zgjedhor të Federatës Shqiptare të Futbollit", u shpreh në fillim Surkis. Zgjedhjet për mandatin e presidentit të federatës, por edhe për Komitetin Ekzekutiv do të monitorohen përpam, gjatë dhe pas procesit dhe mesazhi i UEFA-s është i qartë. "Ndamë opinionet, shpresoj dhe besoj se na dëgjuaan me kujdes. De-

legatët e FIFA dhe UEFA do të jenë të pranishëm në Asamblenë Zgjedhore të 7 shkurtit dhe do të vazhdojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim. Nëse zgjedhjet do të zhvillohen demokratike dhe transparente ne do të përgëzojmë fituesin. Se cili do të fitojë do ta shohim në përfundim të Asamblesë", shtoi më tej zv.presidenti Surkis. Ai nuk preferoi të komentonte nëse ka fakte për ndërhyrjen e palëve të treta në zgjedhjet e FSHF-së, por bëri thirrje se për të ecur përpara

bashkëpunimi i autoriteteve vendore me federatën është i nevojshëm. "Ne nuk jemi hetues dhe as Prokurorë. Ne jemi institucioni përgjegjës për zhvillimin e futbollit në Evropë. Ne kujdesemi për futbollin", kjo është moto jonë. E kuptojmë që zhvillimi i futbollit nuk është i mundur në asnjë vend pa punën dhe energjitë e autoriteteve shtetërore përkrah federatave. Futbolli është një projekt madhor social, që ndikon në jetën dhe mënyrën cilët jemi, goftë në Shqipëri dhe Gjermani apo në Ukrainë e Zvicër. Kudo futbolli është shumë i rëndësishëm dhe mendoj se UEFA është një shembull i mirë për tu ndjekur, duke u kujdesur për futbollin dhe duke shpërndarë të ardhurat për zhvillimin e këtij sporti, kudo. Këto janë qëllimet dhe puna jonë, njerëzit që na ndjekin duhet të bëjnë të njëjtën gjë". Në fund numri 2 i UEFA-s u shfaq i rezervuar edhe rreth takimit me kryeministrin Rama dhe faktit nëse mori garanci se procesi në Asamblenë Zgjedhore të 7 shkurtit do të jetë i pavarur nga politika. "Nuk firmosëm asnjë memorandum, por dëgjuaam njëri-tjetrin dhe besoj se secila palë ka nxjerrë përfundimet e veta. Jemi në një proces që vazhdon dhe këto janë komentet e vetme që mund t'ju jap për momentin. Gjithçka do të bëhet hap pas hapi", përfundoi Surkis.

Muarem pritet të luajë ndaj Kukësit?

Kukësi-Flamurtari është ndeshja më e rëndësishme e javës së 18-të të kampionatit, pasi do të jetë një provë e rëndësishme për dy ekipet, që pretendojnë t'i marrin vendin e parë Skënderbeut. Të dy ekipet kanë shpenzuar shumë në verë dhe tani në merkaton e dimrit. Klubi vlonjat ka afruar lojtarë me kualitet dhe kosto të lartë, që pritet ta rrisin forcën e ekipit. Dy prej tyre kanë debutuar, Nedeljković dhe Zuka, ndërsa për Muaremin dhe Tunkarën stafi teknik vlonjat është në dyshim. Muarem ka lënë pas dëmtimin, kurse Tunkara ka vetëm pak ditë që ka



ardhur në ekip, por ajo që i tremb më shumë drejtuesit e Flamurtarit lidhet me fushën e stadiumit "Zeqir Ymeri", që është me bar sintetik.

Frika për ndonjë dëmtim të mundshëm mund të shtyjë debutimin e dy lojtarëve me fanellën kuqezi për javën e ardhshme.

SHKUPI BARAZON NË MIQËSOREN ME ODESA

Vujçiç debuton me gol

Shkup, 2 shkurt - Futbollistët e Shkupit, më në fund në ndeshjet kontrolluese që po i luan në Antali të Turqisë, e kanë shënuar golin e parë. Ata dje në mëngjes me ukrainasit e Odesa Çernomorez kanë barazuar 1:1. Golin e parë për "pëllumbat" në këto përgatitje e ka shënuar Stefan Vujçiç, për të cilin kjo ishte ndeshja e parë pas rikthimit nga lëndimi. Ndryshe, të parët në epërsi kaluan futbollistët e skuadrës ukrainase, ndërsa deri në ato momente bardhekaltërit nuk arritën ti konkretizojnë disa raste

me çka kundërshtari shfrytëzoi një fusha e lagur bëri që portieri Zendeli të mos arrij të kontrollojë topin, që përfundoi pas vijës fatale. Edhe në pjesën e dytë dominuan djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu si me lojë poashtu edhe me raste, ndërsa rezultatin në 1-1 e barazoi Vujçiç, i cili edhe debutoi në fanellën e FC Shkupi. Ndërkohë, sipas plan programit deri në përfundimin e këtyre përgatitjeve skuadra e Shkupit në Turqi do të luajë edhe një ndeshje kontrolluese. (B.K.)

Një ëndërr që po bëhet realitet

Armando Sadiku, nëpërmjet një postimi në Instagram, ka komentuar hapin e madh që ka bërë në karrierë, me kalimin në La Liga me Levanten. Elbasanasi shprehet se e priste me kohë një moment të tillë, duke thënë se e meritonte edhe më parë. Ai deklaroi se ka punuar gjithmonë, por jo çdo herë ka marrë atë që meriton. "Përsëritje të dashur miq. Nga sot 1 shkurt jam 1 lojtar i Levante UD! Do doja të ju falënderoja për mesazhet e shumta dhe urimet që më keni shkruar! Për mua është një ëndërr që po bëhet realitet! Kam punuar shumë ndonjëherë duke mos marr atë që meritoja Por jam zgjuar edhe kam punuar akoma



më shumë për të arritur këtu ku jam sot vetëm ato persona që me kanë qëndruar pranë e dinë këtë dhe i falënderoj shumë! Faleminderit familjes time shokëve edhe të gjithë shqiptarët kudo që ndodhni që më keni mbështetur gjith-

monë me komplimente! Do përiqem të jap gjithmonë 100 për qindëshin për ekipin tim të ri", ka shkruar në postimin e tij Sadiku. Ndërkohë, Levante ka prezantuar ditën e djeshme blerjet e bëra në merkaton e verës mes tyre edhe Sadikun, i cili ka shkelur kështu për herë të parë tapetin e stadiumit të ekipit të ri. Derisa, Real Madridi do të zbarkojnë në Levante të shtunën në 20:45 dhe do të takojnë Sadikun dhe ekipin e tij të ri. Nuk ishte prenotim por është rastësi. Një arsye më shumë kjo për të gjithë shqiptarë madrilen dhe jomadrilen për ta ndjekur Realin. Fati i keq i Sadikut është se këtë javë për madrilenët kthehet Ramos.





Atletik Bilbao kërkon Ançelotin

Karlo Ançeloti mund të vendoset për një rikthim në La Liga pasi Atletik Bilbao thuhet se është duke kërkuar shërbimet e trajnerit italian. Skuadra e madhe baske po përjeton një sezon jo të mirë duke marr rezultatet zhgënjyese, të cilat e kanë lënë në pjesën e poshtme të tabelës. Sipas mediumi "El Gol Digital", Bilbao janë të gatshëm të shkarkojnë trajnerin Jose Angel Ziganda pas rezultateve të dobëta në La Liga dhe eliminimit në Kopa del Rey. Rrjedhimisht, baskët do të peshojnë mundësitë e tyre, dhe ky medium spanjoll

raporton se italianin Ançeloti është në mesin e të preferuarve. 58-vjeçari ka drejtuar Real Madridin në mes të viteve 2013 dhe 2015, duke i udhëhequr ata në fitimin e kurorës së 10-të të Ligës së Kampionëve në sezonin e tij të parë. Për më tepër, ish-trajneri i Milanit e ka bërë të qartë se ai nuk ka ndërmend të bëhet trajneri i më i ri i Kombëtares së Italisë. Atletik Bilbao, nga ana e tyre, njihen për traditën e tyre të nënshkrimit të vetëm lojtarëve baskë, edhe pse politika e tyre në trajnerë është më e relaksuar. Ndryshe, Ançeloti në herën e fundit ishte trajneri i Bajern Munihut, me të cilët u nda në fillim të këtij sezoni.

**GUARDIOLA NUK HEQ DORË
NGA MBROJTËSI I BAJERNIT**

SITI KA GATI

60 MILIONË EURO

PËR KIMMIH



Manchester Sittit ka autorizuar investimin prej 60 milionë eurosh për të fituar konkurrencën e Barcelonës. Bajerni nuk ka ndërmend ta lejojë të largohet mbrojtësin e djathtë, por do të jetë i detyruar të pranojë 60 milionë euro, nëse futbollisti zgjedh të largohet nga Bundesliga, në verën e ardhshme

Pep Guardiola është gati të punojë sërish me Xhoshua Kimmih, duke sfiduar skuadrën e Barcelonës në garën për të marrë mbrojtësin e Bajern Munihut. E përditshmja gjermane "Bild" ka shkruar se trajneri i Manchester Sittit ka autorizuar investimin prej 60 milionë eurosh për të fituar konkurrencën e Barcelonës. Bajerni nuk ka ndërmend ta

lejojë të largohet mbrojtësin e djathtë, por do të jetë i detyruar të pranojë 60 milionë euro, nëse futbollisti zgjedh të largohet nga Bundesliga, në verën e ardhshme. Drejtori sportiv i Bajern Munihut, Mihael Reshke, tha së fundmi. "Kimmih kushton shumë. Unë nuk mendoj se Bajern do të pranojë më pak se 60 milionë euro". Kimmih, aktua-

lisht mbrojtësi i djathtë i skuadrës së Hejnkës, është etiketuar nga shefi ekzekutiv i Bajernit, Karl-Heinz Rummenigge, si pasardhësi i Filip Lam. Megjithatë, 23-vjeçari është fans i Guardiolas, trajneri që i dha mundësinë e debutimit në "Allianz Arena" dhe do të ishte gati ta ndiqte te Manchester Sitti. "Guardiola pa diçka te unë dhe nuk më ndihmoi vetëm

një apo dy ditë, ai ishte gjatë gjithë kohës në krahun dhe në mendjen time. Nuk ka pasur askush ndikim më të madh se ai në karrierën time. Padyshim që i detyrohem diçka. Më mësoi të se çfarë duhet të përmirësoja në stërvitje dhe ndeshje. Falë tij luajta me Bajernin dhe jam një futbollist më i mirë", deklaroi pak ditë më parë Kimmih.

SIPAS RAPORTIMEVE NGA ANGLIA DHE GJERMANIA

Reali rikthen Rodriguezin në "Bernabeu"

Sipas raportimeve nga Anglia dhe Gjermania, ylli i Bajern Munihi, Hames Rodriguez është gati të rikthehet te Real Madrid në fund të sezonit me Zinedin Zidan që sipas të gjitha gjasave do të shkarkohet. Rodriguez u detyrua të largohet nga Real Madridi gjatë merkatos së verës së kaluar, me kolumbianin që nënshkroi një kontratë 2-vjeçare huazimi te Bajern Munihi. Mungesa e minutazhit dhe hapësirave në "Bernabeu", me dorën e hekurit të trajnerit Zidan, që e linte atë rregullisht në bankinë, shtynë kolumbianin të transferohet në Bundesligë. Ndërkohë, Liverpuli ka zbuluar me ofertën për të blerë përfundimisht



Rodriguezin, nëse do të ekzistojë mundësia pas përfundimit të kontratës së huazimit të tij te Bajern Munihi, në 2019, të bindur se mund të kapërcejnë mundësitë fi-

nanciare të gjermanëve. Sipas medias spanjolle "Don Balon", Rodriguez është i vendosur të rikthehet te "Los Blancos", dhe presidenti Florentino Perez është i gatshëm t'i

plotësojë atij dëshirën. "Don Balon" i referohet pikërisht fjalëve që kanë rrjedhur nga blerja më e fundit e Barcelonës, kolumbianit Jerry Mina. Sipas "Don Balon", lojtari blaugrana ka mësuar se Rodriguez është i dëshpëruar të rikthehet në La Liga. Supozohet se kolumbianin i mungon Spanja dhe u ka thënë drejtuesve të Bajernit, se do të largohet nëse ka qoftë edhe një shans të vogël për t'u rikthyer. Perez është gati ta rikthejë Hames Rodriguezin, me 70-vjeçarin që pritet të shkarkojë francezin Zidan në fund të sezonit. Ishte vendimi i Zidan për të mos aktivizuar kolumbianin që e detyroi këtë të fundit të huazohet te Bajerni.



Zhorginjjo në radarin e Arsenalit

Arsenal ka shfaqur interesimin për mesfushorin e Napolit, Zhorginjjo, sipas asaj që bën të ditur shtypi në Itali. Futbollisti i kombëtares italiane ka qenë një nga lojtarët më të mirë te skuadra që kryeson Serie A me një pikë më shumë se Juventusit. Sipas asaj që shkruan "Tuttomercato", Arsenali mund të investojë te 25-vjeçarin në verën e ardhshme. Zhorginjjo ka shënuar dy gola në 111 ndeshje për Napoli, që kur iu bashkua kësaj skuadre nga Verona në janar të vitit 2014. "Interesimi i Arsenalit është i vërtetë", – tha Santos, menaxheri i futbollistit, për një radio italiane. "Pas ndeshjes kundër Palermos, në fund të sezonit të kaluar, drejtuesit e Arsenalit dhe ata të Real Madridit na bënë disa pyetje. Faktikisht më shumë ishin komplimente sepse biseda merkatoje, prandaj nuk u bë asgjë, por në verë situata mund të ndryshojë". Zhorginjjo ka lindur në Brazil, por ka pasaportë italiane dhe është pjesë e kombëtares "axurre".



I lumtur që qëndrova

Ishte shumë pranë kalimit te Çellsit por në fund marrëveshja u prish dhe Edin Xheko qëndroi te Roma. Megjithatë sulmuesi bosnjak nuk bëhet aspak pishman që nuk iu bashkua skuadrës së Antonio Kontes pasi ai është i lumtur te Roma. Në një intervistë 31-vjeçari ballkanas theksoi se Roma është pjesë e jetës së tij dhe gjithmonë do të jetë. "Është e vërtetë që ekzistoi një kontratë, por në lidhje me këtë argument janë thënë shumë falsitete. Jam i shtangur nga interesimi i shfaqur prej një klubi të madh, sikurse është Çellsit, por jam i lumtur që qëndrova te Roma, sepse kjo është shndërruar në shtëpinë time dhe do të qëndrojë për një kohë të konsiderueshme të jetës time. Këtu lindi djali im. Na mungoi pak fat, por kemi cilësinë e duhur për të dalë nga kripa", deklaroi Xheko.

SIPAS KOMISIONARIT TË FEDERATËS ITALIANE TË FUTBOLLIT ROBERTO FABBRICINI

"Mançini ishte në Romë, por nuk e kontaktoam atë. Konte duket i gatshëm të marrë përsipër drejtimin e kombëtares së Italisë përsëri. Ançeloti hap dhe mbyll derën, ndërsa Ranieri nuk është jashtë këtij interesimi", – tha Fabbriçini, i cili u emërua komisionar të enjten, pas zgjedhjeve, ku nuk u gjet dot një zëvendësim për ish-presidentin Karlo Taveçio



KONTE I GATSHËM TË KTHEHET NË DREJTIMIN E ITALISË

Antonio Konte është "i etur" për t'u rikthyer në rolin e tij si trajner i Italisë, sipas komisionarit të Federatës Italiane të Futbollit (FIGC), Roberto Fabbriçini. FIGC është ende në kërkim të zëvendësuesit të Xhan Piero Ventura, i cili kryesoi humbjen totale 1-0 të Italisë me Suedinë, në ndeshjen "play-off" të Kupës së Botës, pas së cilës axurrët dështuan të arrijnë në turneun e madh të kësaj vere, për herë të parë që nga viti 1958. "Kuarteti" italian; Konte, ish-tekniku i Bayern Munihi, Karlo Ançeloti, trajneri i Zenit, Roberto Mançini dhe "bosi" i Nantes, Klauudio Ranieri, janë lidhur të gjithë me postin vakant.

Konte ishte në krye të kombëtares blu në periudhën 2014-2016, duke e drejtuar Italinë në çerekfinale të "Euro 2016", para se të ba-

shkohej me Çellsin, ku fitoi titullin e Premier Ligës në sezonin e kaluar dhe 48-vjeçari, i cili thuhet se është i pakënaqur në "Stamford Bridge" mbi transferimet, dëshiron të punojë përsëri me ekipin kombëtar, sipas Fabbriçini. "Mançini ishte në Romë, por nuk e kontaktoam atë. Konte duket i gatshëm të marrë përsipër drejtimin e kombë-

tares së Italisë përsëri. Ançeloti hap dhe mbyll derën, ndërsa Ranieri nuk është jashtë këtij interesimi", – tha Fabbriçini, i cili u emërua komisionar të enjten, pas zgjedhjeve, ku nuk u gjet dot një zëvendësim për ish-presidentin Karlo Taveçio. "Nuk është askush në 'pole position', ne duhet të vlerësojmë 'pro' dhe 'kundra'. Ne, gjithashtu, duhet

të vlerësojmë disponueshmërinë e federatës dhe t'u shpjegojmë atyre që do të vijnë pas nesh, që do të ketë qeverisje të re".

Mbrojtja e titullit nga Çellsin është pothuajse e pamundur, pasi humbja e së mërkurës, 3-0 në shtëpi, ndaj Burnmaut, i la londinezët 18 pikë prapa liderëve të Premier Ligës, Mançester Siti.

KONTEN E SHPËTON VETËM TRIUMFI NË ÇAMPIONS

Megjithëse Çellsin më në fund mori sulmuesin që kërkonte gjatë gjithë janarit, mesa duket Konte nuk do të mundet ta shpëtojë postin e tij. Në klub ka një ndjesi që ai do të shkarkohet në fund të sezonit dhe e vetmja gjë që mund t'i shpëtojë punën është triumfi në Ligën e kampionëve, diçka që nuk ka shumë gjasa të ndodhë. Fakti që Konte fitoi titullin vitin e kaluar duke befasuar të gjithë dhe finalja e "FA Cup" do të harrohet shumë shpejt

nga pronari i Bluve. Abramoviç njihet si një pronar i paskrupullt dhe ka shkarkuar emra si Murinjo dhe Ançeloti në të shkuarën. Konte është një trajner kokëfortë, dhe shpeshherë ka kritikuar drejtuesit me deklaratat e tij të kamufluara. Drejtuesit kanë dëgjuar me vëmendje, dhe nëse situata nuk ndryshon në ndeshjet e ardhshme, shkarkimi i tij mund të vijë edhe përpara se të përfundojë sezoni.

Dybala shpreson të jetë gati kundër Totenhemit

Paulo Dybala po e provon, Juventus po shpreson! Data që ka rëndësi mbi të gjitha është ajo e sfidës së parë për 1/8-të e finaleve të Çampions Ligës kundër Totenhemit, 13 shkurti i ardhshëm. Sulmuesi argjentinas do të bëjë të pamundurën për të qenë në fushë dhe rreth tij ka optimizëm, sepse kontrolli mjekësor i bërë tregoi se lojtari ka bërë progres drejt riaftësisimit. Tërheqja muskulore e pësuar në ndeshjen ndaj Kaljarit thuhet ka ikur dhe numri 10 i bardhezinjëve mund të fillojë gradualisht stërvitjen. Për një javë ai do të stërvitet veçmas, ndërsa javën tjetër do të bëhet pjesë e grupit, pikërisht 7 ditë para ndeshjes më të rëndësishme të Juventusit deri në këtë pikë të sezonit. Ndjesia është që Dybala nuk do të jetë titullar kundër Totenhemit, por kryesorja është që do të jetë në dispozicion të trajnerit Alegri dhe mund të aktivizohet gjatë ndeshjes. Shumë do të varet nga mënyra si do të reagojë muskulli i Dybala gjatë një ngarkesës që do të marrë në javën e ardhshme. Alegri po mban frymën, ashtu si tifozët, teksa ka ardhur largimi i mirë se Daglas Kosta dhe Bernardeski nuk kanë pësuar asnjë dëmtim të rëndë. Dy lojtarët që luajnë në krahët e sulmit ndoshta mund të mungojnë kundër Sassuolo, por do të jenë rregullisht në fushë në Çampions.

Emery dyshonte se Moura ishte "spiuni" i PSZH-së



Një ditë pasi Totenhemi shpalli transferimin e Lukas Moura, shtypi francez ka zbuluar një nga arsytet pse mesfushori u largua nga Paris Sen-Zhermen. "Le Parisien" raporton të enjten se trajneri Unai Emery nuk e pëlqente brazilianin dhe kishte dyshime se ishte spiuni i skuadrës. Sipas së përditshmes franceze, stafi teknik hamendësoi se ai i jepte shtypit informacione në lidhje me Nejmar dhe Kavanin, për shembull. E njëjta gjë mendohej edhe për Ben Afra. Mungesa e besimit

të trajnerit bëri që ai të shiste yllin brazilian. Ndjekësit e Emery kanë përsëritur gjithmonë se të dy lojtarët ishin të padëshiruar. Por Nejmar nuk ishte i lumtur me largimin e mikut të tij Lukas. "Le Parisien" ka theksuar zhgënjimin e numrit 10 për transferimin e Lukas, megjithëse ai kishte thënë se donte që ai të qëndronte. Lukas, i cili është 25 vjeç, nënshkroi me Totenhemin deri më 30 qershor të 2023. Ai nuk ka luajtur pothuajse fare nën drejtimin e Unai Emery.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do jeni shume te arte per ate qe doni te beni sot ne lidhjen tuaj dhe do flisni seriozisht me partnerin. Ai do tregohet i kuptueshem dhe do pranojne cdo vendim tuajin. Beqaret nuk do jene shume ne humor per te kerkuar dashurine dhe do vazhdojne te kenë te njëjtin status. Financat duhen menaxhuar me shume kujdes dhe largpamësi.

DEMI 21. prill - 21. maj

Do mbylleni ne vetvete gjate kesaj dite dhe nuk do i shprehni asgje atij qe keni ne krah. Kjo do krijojë një hendek te thelle ndërmjet jush i cili vështirë se do mbushet aq lehte. Beqaret do kenë një takim te papritur, por qe mund t'ua ndryshojë jetën përgjithmonë. Ne planin financiar nuk dini çfarë hapash te hidhni qe ta përmirësoni situatën. Kërkoni ndihme!

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dite mjaft e qëndrueshme kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje qe prej shume kohesh. Disa do mendojnë edhe për një bashkëjetesë te mundshme. Beqaret duhet te bëjnë kujdes para se te hedhin cdo lloj hapi. Mos iu besoni fjalëve shume te bukura te disa personave. Financat do kenë goxha tronditje për shkak te shpenzimeve te mëdha qe keni kryer kohet e fundit.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do bëni shume peshime ndaj partnerit tuaj sot dhe marrëdhënia mes jush do fillojë te jete me e ngrohte se dikur. Për cdo gjë do flisni hapur me te. Beqaret do kalojnë shume kohe me miqtë dhe nuk do kenë kohe te kërkojnë dashurinë. Lërjani gjithçka ne dore planetëve. Ne planin financiar duhet te tregoheni te arsyeshëm dhe te mundoheni ta përmirësoni situatën.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Influenca e yjeve ne planin tuaj sentimental do jete shume kontradiktore sot. Matuni mire para se te flisni me partnerin sepse ne je moment ai mund te jete me nerva dhe do debatoni ashpër. Beqaret do jene shume sensuale dhe do marrin ftesa për te dale neper takime. Financat do jene përgjithësisht te mbrojtura kështu qe mund te rini te qete ne këtë plan.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Jeta ne çift do iu sjelle shume gëzim dhe harmoni gjate kesaj dite. Do kaloni momente vërtet emocionuese dhe do dëshironi qe dita te mos mbarojë. Beqaret duhet t'i marrin gjerat shtruar dhe jo te krijojnë një lidhje sa për sy e faqe. Ne fund te fundit është jeta e tyre. Për shkak te disa shpenzimeve urgjente qe do iu duhet te bëni situata do jete delikate.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Perspektivat janë shume te mira për jetën tuaj ne çift sot. Partneri do iu surprizojë ne cdo moment dhe do iu beje te ndiheni ne cdo moment te dëshiruara. Beqaret me shume gjasa do njohin persona te rinj me te cilët do ia vlejte te nisin histori dashurie. Paratë do duhet t'i menaxhoni me kujdes dhe maturi. Situata nuk është aq e qëndrueshme sa ju mendonit.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

eta juaj ne çift do jete gjate gjithë kohës e mbrojtur. Gjithçka do e bëni ne bashkëpunim me partnerin dhe nuk do i mbani aspak mëri atij për sjelljen jo shume te mire gjate kohëve te fundit. Një pjese e beqareve do fillojnë aventura kalimtare, ndërsa një pjese do duan te shijojnë lirinë qe kane. Financat do lënë goxha për te deshifruar. Beni kujdes!

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dëgjojeni ato qe do iu thotë partneri juaj sot sepse përndryshe do keni debatet te ashpra me te. Gjithmonë mund te gjendet koha e duhur për te bashkëbiseduar qetësisht. Miqtë do i prezantojnë beqaret me persona mjaft interesante, por ata do jene te turpshëm dhe nuk do përfitojnë aspak. Ne planin financiar mos luani shume me zjarrin sepse do digjeni keq.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Bashkëpunimi dhe besimi reciprok do mbizotërojnë gjate gjithë kesaj dite ndërmjet jush dhe atij qe keni ne krah. Atmosfera do jete përgjithësisht e ngrohte dhe pa probleme. Beqaret do tërhiqen mjaft nga persona te cilët kane një lidhje tjetër. Kujdes, mos bëni gjera për te cilat do pendoheni. Financat do jene te paqëndrueshme, prandaj duhen marre masa strikte.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Partneri do iu beje një propozim mbresëlënës gjate kesaj dite te cilin ju duhet ta pranoni pa u menduar dy here. Te gjithë ëndërrojnë atë qe do iu ndodhe juve. Beqaret do kërkojnë ne cdo vend, por serish nuk do e gjejnë dot personin e duhur. Financat do jene te mira, kështu qe mund ta shlyeni borxhin qe keni mare para disa kohesh dhe te jeni te qete.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Perspektivat për jetën tuaj ne çift janë shume te mira gjate kesaj dite. Do ndiheni me se miri ne krahët e atij qe dashuron i dhe nuk do ia prishni qejfin njeri-tjetrit. Beqaret nuk do jene gati për te krijuar një lidhje dhe do vazhdojnë te kenë te njëjtin status. Ne planin financiar do kaloni disa vështirësi te vogla, por situata do fillojë te stabilizohet shume shpejt.

Koha Koha	AKTORI AMERIKAN NGA FOTO	BARBARIZMI NDËRTESA KU MBAHEN BAGËTIT	GOTË E METALTË									
PJESË E TASTATURËS (pashq.)												
I MESËM, E MESME (turq.)												
PAS, PRAPA												
BRENGË, DERT DËSHIRË, KURESHTJE									FILMI I TYRE			
					DAJRE			SHKRIMTARI AMERIKAN, HEMINGUEJ ITALIA	TETOVA	TOKA E BUKËS	KRYEQYTETI I SHQIPËRISË	I BASHKUAR
NIKEL		AKTORJA FRANCEZE NGA FOTO KRYENGRITËS I PAORGANIZUAR										
KREATOR MODE, PJER								EMËR POETIK I IRLANDËS				
SUEDIA		INXHINIERI FRANCEZ, GUSTAV TAVOLINË KU CELEBROHET MESHHA							100 m2 TIPI I PARË, FILLESTAR I DIÇKAJE (shq.)			
Koha	LIMAN NË SUEDI THIKA NË TYTËN E PUSHKËS				TRA MBAJTËS I TAVANIT					BARDHË (turq.)		
QYTET-LIQE NË SLLOVENI					DESPOT MJETI PËR SHOSHITJE					TË FTOHTË I MADH		DIAMETËR I PREDHËS OSE I FISHEKUT
LIBËR HARTASH								KAPTELLI I SHALES (pashq.) LLOJ PESHKU I UJRAVE TË ËMBELA				
AFIRMACIONI GJERMAN					ETIKETA (frenq.) DJALI I MADH I ADAMIT DHE EVËS							AUSTRIA POPULL ZEZAK QË JETON NË NIGERI
PEZMATIMI I VEZORËVE (mjek.)								GOJOR PËRKULET				
NORVEGJIA ÇEKAN		KRONIKAT FIZIKANI SKOCEZ, XHON								KLINT ISTVUD		
								FRIKË NGA BLETAT SIMBOL I KIMIK I SAMARIUM-IT				
"SPORT I BARDHË"								GJINI LETR. QË TREGON BËMAT HEROIJE ENERGJI				
I ARITMETIKËS												

FJALËKRYQ KLASIK

	1	2	3		4	5	6		
						8			9
10					11				12
		13		14					
15	16		17						18
19		20						21	
22								23	24
	25							26	
									27

- HORIZONTALISHT:**
 1. Zatehem me miq, shokë etj.; 7. Degë e lumit Danub; 8. Kampionet; 10. Mbrëmje vallëzimi (vjet.); 11. Pezmatimi i kyçeve; 13. Monopolizime; 15. Notë muzikore; 17. Prefiks me kuptim - erë; 18. Zero, gram; 19. Vendosje, vënie në funksion (sh.pashq.); 22. Lumë në Evropë; 23. Afroj; 25. Përvetësosa; 26. Aktorja amerikane, Bening; 27. Barazoj.
- VERTIKALISHT:**
 1. Bëra shaka, e përqesha; 2. Detyra e avokatit; 3. Posedon; 4. E kundërta e hallallit; 5. Tërbim dashuror; 6. Tenistja amerikane, ...Xho Fernandez; 7. Në ç'masë; 9. Aktori ynë, Filloko; 10. Automobili në F1; 11. Thirrje e përgjithshme (shq.); 12. Ngjyrë e kaltër e mbyllët; 14. Lumë në Sibir; 16. Emri i vjetër i Vietnamit; 20. Mendjemadh, sqimatar; 21. Po (turq.); 24. Film i Spielbergut; 26. Antonio Banderas.

ZGJIDHET: B. TAST, ORTA, MBAS, HALL, MERRAK, E. NI, ODRI TATU, KARDEN, ERIN, S. EIFEL, ARI, ABI, SAP, AK, BLEED, TIRAN, ATLAS, KOÇAK, JA, VJNETA, A. ORKITI, ORAL, N. ANALET, KI, ÇEKIÇ, APİFOB, TENIS, EPİKE, ARITMETIKOR, FJALËKR. KLASIK: TAKOHEM, SAVA, ASET, BALLO, ARTRIT, O. AKPARIME, LA, ANEMO, OG, INSTALIME, E, DANUBI, AVIT, MORA, ANET, BARABIT.

Imazh i pazakontë, minarja shfaqet nga liqeni i ngrirë



Minarja e cila ngritet në mes të liqenit në lindje të Turqisë është kthyer në një atraksion turistik, e cila në mënyrë të veçantë të tërheq vëmendjen e turistëve në dimër kur sipërfaqja e liqenit mbulohet me akull, raporton AA. Kjo është minarja e xhamisë që mbeti nën ujë pas mbushjes së digës Yazici në vitin 2009. Diga i shërben nevojave të hidrocentralit me të njëjtin emër, por edhe për ujitjen e më shumë se 25 mijë hektarëve të tokës bujqësore në Agri. Së bashku me një pjesë të fshatit

Bascavus, nën ujë mbeti edhe xhamia lokale kurse minarja vazhdon të qëndrojë drejtë në mes të liqenit. Rreth 18 kilometra larg nga qendra e Agrit, minarja është bërë një atraksion i madh turistik i vizituar nga vendorët e zhvendosur të këtij fshati, por edhe nga turistët nga e gjithë Turqia dhe më gjerë. Minarja në mes të një liqeni të ngrirë është një skenë që tërheq fotografët profesionistë dhe ata amatorë në kërkim të imazheve të pazakonta.

E dashura xhelozë i pret organin gjenital të dashurit të saj

Një grua xhelozë dyshohet se ka prerë penisin e të dashurit të saj, pasi ka parë që ai i ka bërë komplimente një gruaje tjetër. Zhanna Nurzhanova, 36 vjeç, ishte



e zemëruar kur i dashuri i saj i kishte dërguar motrës së tij foto të një gruaje tjetër në telefon. Burri, emri i të cilit nuk bëhet publik, bëri një kompliment për një grua e cila mendohet të jetë një person i

njohur për çiftin. Nurzhanova akuzohet se i ka dhënë të dashurit të saj një pilulë për ta vënë në gjumë dhe ka pritur që ai të flejë ku më pas ka tentuar t'i presë penisin. Nurzhanova thuhet se e ka çuar atë në një spital lokal për të marrë ndihmën mjekësore, ku mjekët njoftuan policinë dhe ajo u arrestua.



Alarmi për prindërit, mos flini me foshnjat tuaja!

Një total prej 665 foshnjash kanë vdekur që nga viti 2013, duke qenë se flinin në të njëjtin shtrat me prindërit e tyre, me 141 të vdekur vetëm gjatë 12 muajve të fundit në Britaninë e Madhe. Të fjeturit bashkë me fëmijën, ka sjellë pasoja të rënda me 133 bebe të vrara pothuajse çdo javë, në raste të zënies së frymës, nga nxehtësia e tepërt ose Sindromi i Vdekjes së Foshnjës Papritur. Foshnjat kanë një rrezik më të madh për të vdekur nëse gjatë fjetjes me prindërit ata janë nënsheshë, ose kanë lindur parakohe. The Lullaby Trust, or-

ganizata britanike që synon të parandalojë vdekjet e foshnjat, paralajmëron se ndarja e një shtrati me foshnjat rrit rrezikun edhe për prindërit, dhe u kërkon nënave dhe prindërve të rinj që të jenë të vetëdijshëm për kërcënimin. "Disa prindër zgjedhin të ndajnë një shtrat me fëmijën e tyre, por ne rekomandojmë që ata të mbajnë parasysh faktorët e rrezikut", tha ajo për Mirror Online. Mundësia e vdekjes së papritur rritet kur ndan shtratin me prindër që janë përdorues të cigares, alkoolit ose që janë shumë të lodhur.



Ariu shtyn invalidin në karrigen me rrota

Të shohësh një ari që shtyn një njeri me një karrocë nuk është gjëja e parë që prisni të shihni në rrugët e Moskës, por pikërisht kjo ishte ajo që "Yasha Bear" po bënte të martën. Trajneri Oleg Aleksandrov pësoi një aksident në qarkun Nizhegorodsky, duke rënë nga 18 metra e për pasojë duke thyer këmbët dhe një krah. Ai po rriste tre arinj të vegjël atë kohë. Megjithatë, pas aksidentit, Oleg u shtrua në spital dhe u hoq nga arinjtë e tij ose "fëmijët me flokë" siç i thërriste ai për katër muaj. "Isha shumë i shqetësuar se si do të ndryshonte marrëdhënia jonë", - tha ai, duke shtuar se ky mendim po i qarkullonte në kokë gjatë gjithë kohës që isha në spital, por imagjinoj nëse do të më praninin. Ishe distanca mes nesh".

1377 – Ekzekutim masiv i popullatës në Çezena të Italisë.

1451 - Sulltan Mehmedi II trashëgon fronin e Perandorisë Osmane.

1690 – Lëshohet në përdorim bankënota e parë në Amerikë.

1783 – Spanja njeh pavarësinë e SHBA.

1815 – Fabrika e parë komerciale e djathit në botë themelohet në Zvicër

1830 – Sovraniteti i Greqisë konfirmohet në Protokollin e Londrës.

1915 – Ushtria turke dhe gjermane arrijnë Kanalin e Suezit.

1919 – Mbahet takimi i parë i Lidhjes së Kombeve në Paris.

1964 – Nxënësit zezak dhe portorikan bojkotojnë mësimin në shkollat e qytetit të Nju Jorkut.

1994 – Presidenti Bill Klinton heq embargon tregtare të Amerikës kundër Vietnamit.

1998 – Britania e Madhe lëshon në përdorim pullat postale të Princeshës Diana.

Numri maksimal i golave të shënuar nga një lojtar, në një ndeshje të vetme futbollit është 16. Ato u shënuan nga Stefan Stenis (Francë) gjatë Racing Club de Lens në dhjetor 1942.



Klubi i parë i futbollit në botë është klubi anglez Sheffild Junajted. Ai u themelua në vitin 1857 nga koloneli Nataniel Kresuik dhe majori Uil-liam Prist, dy oficerë të ushtrisë britanike.



Astronauti Neil Armstrong fillimisht donte që të merrte me vete gjatë misionit në Hënë një top futbollit, por NASA e pengoi pasi e cilësoi atë si një simbol joamerikan.



TETOVARËT NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK Një ditë tre tetovarë shkuan të kopshti zoologjik, por te hyrja ishte roja i alarmuar.

Roja: Më vjen keq djema, nuk mund të hyni se sapo morëm vesh që luani ka dalë nga kafazi?!

Tetovarët: Ore hape derën se s'ta ha njeri luanin!



Imagjinata i është dhënë njeriut për të kompensuar atë që ai nuk është, dhe një sens humori për të ngushëlluar veten për atë që është.

(Oscar Wilde)



KALENDARI HISTORIK 3 JSHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS